

ZIJA ÇELA
DJALLI KOMIK
ROMAN

BOTIMET TOENA

Zija Çela

Djalli komik

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore letrare: Anrila Spahija

Përkujdesja grafike: Arlinda Rrushi

Kopertina: Elsa Hajderaaj

Në kopertinë: “Valsi i hezitimit” nga René Magritte

ISBN 978-9928-277-16-9

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

FUNDI I NGJARJEVE, sipas THE END

Gjatë gjithë seancave të nxehta, që e mbajtën në trysni qytetin tonë, pa pranuar avokat dhe pa asnjë prapamendim për apelimin e dënimit, ai mori përsipër gjithë sa kishte ndodhur. Me pak përjashtime, të akuzuarit e tjerë i shpë-tuan ndëshkimit me burgosje, duke u dënuar me gjoba financiare dhe shërbime prove.

Kur po e nxirrnin nga gjykata, siç do të pohonte Atë Kurjeli, i cili e ndoqi ngjarjen në ekran, ai dukej sikur po u thoshte bashkëqytetarëve të tij: “Unë do të kem sërish paqe, vetëm kur ta di se ju jeni mirë, mirë trup e frymë.” Mirëpo ata që prisnin jashtë dhe e shihnin drejtpërdrejt, patën tjetër ndjesi. Meqë kishin besuar vetëm në një vendim, lirim në sallë, ata nuk po u besonin syve: “Lartmadhëria në hekura?!”

Ishte e çuditshme si ndihej vringëllima e hekurave, megjithëse për t’ia mbuluar prangat, shoqëruesit me uniformë i kishin hedhur xhupin dimëror mes duarve. Shì në tremën me kolona bazalti, Aranit Lumbardi u dha

krahëve përpjetë duke e flakur plaçkën dhe, pasi bëri zap pësjhtjellimin e tij, iu drejtua turmës përballë:

- Doni ta dini? Unë, unë jam fajtori! Por vetë faji është i tjetërkujt.

Të nesërmen, gazeta Gafil e la jashtë kronikës së saj një episod spekulativ, që u mor vesh pakëz më vonë. Madje përkrah kronikës së gjyqit, çfarë s'kishte ndodhur ndonjëherë, nxori në faqe të parë edhe rubrikën Hidh e Prit, ku spikaste titulli: "Dikush flet me Zotin". Përkundrazi, për një goditje me bërryl, konkurrentja The End e përfshiu episodin. Raportimin nga gjykata e mbylli pikërisht me atë spekulim.

Në pamundësi emocionale për t'u ndodhur në sallë, gruaja e Lumbardit ishte mbyllur në shtëpi. Ledi Sara po ndiqte seancën vendimtare në kanalin BiBo TV, kur lëshoi një britmë aq përvëluese, sa fqinjët e përhapën menjëherë. Pastaj, teksa kalonte gojë më gojë, u tjetërsua në përmbajtje. Mirëpo dëshmitari okular Daniel Shestani, i kontaktuar me telefon, e hodhi poshtë thashethemin. Megjithatë, The End shtonte spicën: "E ç'donte Danieli në shtëpinë e ungjit vetëm për vetëm me Sarën në atë orë?" Sipas kësaj gazete, ky qe fundi i ngjarjeve të bujshme, që për disa kohë trazuan tërë rajonin, duke tërhequr vëmendjen e qendrave ndërkombëtare të vendosjes.

Një mendje më thotë se, gjatë rrëfimit, kanë për të folur shumë qytetarë të Horketës. Edhe Sara Çesku, diva jonë. Nëse ju do të keni pyetje, mund t'ua bëni. Por me mua nuk keni punë, unë kam zgjedhur të mbetem anonim.

FILLIMI I NGJARJEVE, sipas DANIELIT

DANIELI 1: Kur sëmundja misterioze u bë më kërcënuese dhe njerëzit po kërkonin të largoheshin nga Horketa, si prej një zone lufte, katër qytetet kufitare vendosën të mbroheshin së bashku kundër nesh, pa iu skuqur faqja për tejkalimin e forcës. Dhe ndonjë akt ndjese nga Rajoni i Bashkuar nuk erdhi kurrë.

Nuk di përse, përfaqësuesit e nivelit të lartë zgjodhën për takimin zyrtar një zonë neutrale. Ata u mblodhën rreth njëzet e pesë kilometra larg qytetit të Fierit dhe, pas diskutimeve të gjata, dolën me një dokument, që mori emrin e fshatit ku u hartua: Traktati i Marrëveshjes Shegan. Lajmet bënë të ditur të gjitha procedurat e reja, lehtësitë dhe kufizimet e lëvizjes në territoret e Unionit, si dhe rregullat shtrënguese për emigrantët. Me të hyrë në zbatim marrëveshja, shi në kohën më urgjente dhe më globaliste, ne u ndjemë menjëherë të izoluar, sepse të tillë e kemi pozicionin gjeografik.

Në veri Horketa jonë kufizohet nga Segardi, që e mban veten si Stalingradi i L2B (Luftës së Dytë Botërore), ndonëse dy pushkë ka shkrehur kundër nazistëve dhe tri kundër fashistëve. Në jug është Likava, që për disa tingëllon si Varshava, për të tjerë si Bratislava. Sa për kufirin lindor, për shkak të territorit që na kanë rrëmbyer, në Horketa flitet gjithë pezmatim. Por edhe me ironi, duke sjellë në mend fushat e paana, pjellorinë e tyre dhe një krrak-krrak të pandalshëm gjatë zhegut të verës. Me të pyetur ku bie Vitistani, asnjë grimë nuk vonon përgjigjja: “Atje ku pëlçet bostani!”

Ndërsa fqinji perëndimor shtrihet deri në brigjet e detit. Dhe ky, në tërë rajonin përreth, është superfuqia. Por as ne nuk e fshehim, Hamivurgu na duket shpesh si Hamburgu. Ka që thonë si Strasburgu, madje për shkak të lumit edhe si Salzburgu. Por në të gjitha portat hyrëse, vetë autoritetet e atjeshme janë mjaftuar me tabelat Hamivurg City.

DANIELI 2: Për sëmundjen misterioze pati kundërthënie midis nesh. Cili ishte rasti i parë dhe i prekuri i parë, kujt t’ia vinim gishtin? Në atë kaos secili kapej pas fillit të vet, duke e katranosur tërë lëmshin. Prandaj nuk mëtoj më tepër se dëshminë e dëshmitarit.

Studioja ime e dizajnit ndodhet në mes të rrugës tregtare “Beqir Alla”. Andej po ecja, kur pashë një qytetar që ndaloj përballë meje krejt papritur, i gjithë trupi iu përpëliti një çast, pastaj stop (!) në vend. Sado e pyeta çfarë kishte pësuar dhe nëse donte ndihmë, nuk mora përgjigje. Ai kishte qenë duke ngrënë diçka, sepse

në një rrëzë dorë mbante ushqimin, në tjetrën kanaçen me lëngun shoqërues.

Fytyra e tij e ngurosur, ku qe ruajtur trajta e fundit që kishte përjetuar, më kujtoi portretet në Muzeun e Dyllit, që përfshihet edhe në guidën turistike të Horketës. Por përveçse nuk fliste, gjithë sa u mblodhëm rreth tij, kuptuam se as dëgjonte. Për ndryshe, do të jepte ndonjë shenjë. Dikush tha se fatkeqit i kishte rënë vilania, çka e acaroi Fanida Rushanin, e cila iu kthye menjëherë, i ke mendtë në kokë apo jo, po të ishte vilani, do të shembej përtokë! Megjithatë, për ta sjellë në vete, i vuri flakën një shamie dhe ia afroi pranë hundës, në mënyrë që tymi ta bënte të përlojej e të teshtinte. Shamia u shkumbua, ndërsa fatkeqit s'i luajti qerpiku.

Vetvetiu filluam ta preknim nga pak, por me kujdes e dhembshuri. Për ta rritur dozën, ose për ndonjë inat të vjetër, një taravol ia veshi shuplakë turinjve. Dhe meqë mbeti i pakënaqur, ia ngjeshi edhe në faqen tjetër. Por sërish pa rezultat. Atëherë taravoli nxori një pistoletë dhe nisi ta paralajmëronte:

- Deri në dhjetë do të numëroj, në njëmbëdhjetë nuk shkoj. Po nuk hodhe tre hapa para, në lule të ballit e ke plumbin!

Kur arriti te pesa, na ftoi edhe ne të numëronim në kor, sepse kërcënimi ndoshta merrej më seriozisht. Por huq se huq. Mor pizeveng, i dha ultimatum taravoli, mua nuk ka burrë nëne të ma bëjë trurin tallash! Dhe në çast shkeli këmbëzën, duke na llahtaritur të gjithëve. Mekanizmi kërciti, por arma nuk kishte qenë e mbushur.

- Përse nuk e kthen nga vetja tani?! - u hodh e tronditur nënolja Fanida Rushani. - Ktheje pra, bëje ruletë ruse!

Turma, sidomos ata që kishin dashur t'ia mbanin dorën, u çlirua disi. Por as pistolieri nuk e zgjati. Me të parë togerin teksa afrohej, ia mbathi në drejtim të kundërt.

Isuf Matrallozi ishte polici më i vjetër në Horketa. Pasi kishte shërbyer për shtatëmbëdhjetë vjet në policinë e rendit, mbante postin e komandimit në policinë bashkiake. Ai po afrohej vetë i dytë. Rrugës ishte bashkuar rastësisht me doktor Karapicin, i cili kishte vajtur në dyqanin e qenve për një këlysh pekinez, por kësaj here ishte kthyer pa kapërcyer as pragun. Rrallë, fort rrallë, vetëm kur u duhej të thumbonin njëri-tjetrin, kjo dyshe kundërshtarësh mund të shihej bashkë. Dhe, me ç'dukej, me thumba po merreshin. Veçse në ankthin tonë e qeshura e tyre ngjante krejt pa vend.

- Ç'ma ke këtë gushë lepuri ti? Pse të dridhet fër-fër?

- më pyeti Matrallozi, pasi e informova për ngjarjen.

- Toger, është...

- S'ka është, *ishte* thuaj, - ma preu fjalën në mes, si t'i kishte dhënë zgjidhje situatës ende pa e njohur.

E para gjë që ftilloi, ishte mundësia e një parkimi të gabuar. Prandaj vështroi rreth e rrotull për ta identifikuar makinën e këtij *subjekti*. Mbasi sytë s'i zunë ndonjë gabim, si njeri që nuk i qante puna në dorë, duke dashur t'i kujtonte se po pengonte qarkullimin e këmbësorëve në trotuar, Matrallozi i mbushi bulçitë mirë dhe i fryu bilbilit. Meqë s'pati reagim, kaloi te masa ndëshkimore, të cilën në fakt e kishte pasur në mend prej fillimit. Mirëpo shkelësi i rregullave njëlloj nuk ia vari. Përveçse nuk bëri as përpjekjen më të vogël për t'u deklaruar nëse e pranonte gjositjen, edhe kuponin që Matrallozi

ia rراسi në dorën ku mbante byrekun, e la të binte si të ishte pusullë bakalli. Atëherë, pa mundur të gjente shteg tjetër, togeri njoftoi patrullën me furgon. Mirëpo, i mësuar që në rastet e qarkullimit t’i drejtohej të njëjtit klient privat, pa dashje atij ia bëri thirrjen telefonike.

DANIELI 3: Ndërkaq, ndonëse Karapici s’e kishte me vete çantën e mjekut, mbetej ende një shpresë. Aq më tepër që e njihte mirë pacientin, të cilin nisi ta prekte në telat më intimë. Si të hamendësonte ndonjë humbje të përkohshme të kujtesës, doktori ia përmendi me emër të shoqen, fëmijët dhe motrat. I nxitur nga veset prej horri, siç e mbanin në qytet, u shty deri në përcëllima të atilla, sa edhe një burri të lindur shurdhmemec do t’i vinte gjuha. Doktori i tha se në vitin e parë të martesës, kur Tamara e tij kishte qenë e re dhe e pahapur nga lindjet, ai ia kishte palluar të shoqen disa herë në shtratin bashkëshortor, por edhe në tapetet e rërës përgjatë lumit. Madje edhe tash vonë, më tepër nga malli se nga halli, kishin bërë seks shqeto në Hotel Alma Palma. A dëgjon, mor humbameno, bëhu burrë pra dhe m’i ngul thonjtë në fyt, se nuk kam çfarë të sajoi më tepër, u dorëzua Karapici.

- As boja e fytyrës s’po më pëlqen. Mos ka vdekur? - hodhi hipotezën e vet orëndreqësi i rrugës tregtare. - Ky është bërë dru, sikur sapo e kanë nxjerrë nga frigoriferi i morgut.

Naiviteti i tij e acaroi edhe më tepër Fanida Rushanin që, përveçse këpucët manushaqe ia vrisnin thembrat, atë punën e morgut e kishte siklet të madh, sepse e kishte provuar vetë dhe nuk duronte ta thumbonin të

tjerët. Prandaj, duke shpresuar se po jepte një sqarim përfundimtar, iu vardis orëndreqësit: Dëgjo, mor orëlig! Vilania është më pak se vdekja, vdekja është më shumë se vilania. Përderisa një i vilanosur nuk qëndron dot mbi këmbët e tij, atëherë si mundet të qëndrojë i vdekuri?! Por zemra ime, edhe pse iu ndal tik-taku njëherë, nuk u ngjan orëve tuaja roskope. Siç po e sheh zotrote, më këmbë jam gjithnjë!

I nxitur nga zanati i tij, doktor Karapici mbështeti kokën te gjoksi i Dino Jaupit dhe u vu t'i përgjonte zemrën. Ai nuk tha nëse zemra rrihte, por as pohoi se i kishte pushuar. Doktorin tha vetëm se ndodhej para një paralize aq të rrufeshme dhe aq agresive, sa kurrë s'e kishte hasur asgjëkundi. Dhe me *asgjëkundi*, përveç viteve të studimit në Poloni, ai përfshinte edhe të gjitha përvojat seminariste nëpër Europë.

DANIELI 4: Ndryshe nga doktori, për të mos u dukur i falimentuar para turmës, toger Matrallozi e ndau mendjen, do ta arrestonte të pabindurin. Dhe meqë mësoi nga Karapici se cili ishte e me çfarë merrej, duke u kujtuar për betejat ndaj kundërvajtjeve që bënte çadra e cirkut, iu drejtua me mllef të dyfishtë:

- Për të fundit herë të jap një shans, palaço! Nëse të rren rradakja se palaçollëqet e tua mund t'i bësh edhe në rrugë, paç veten më qafë, se me ligjin nuk kruhesh dot. Prandaj mblidhe mendjen e lëviz, mos më detyro të përdor forcën.

Për tolerancë togeri priti sërish rreth pesë sekonda. Pasi klouni i cirkut e vazhdoi palaçollëkun, duke treguar

mosbindje civile, hoqi prangat nga rripi i pantallonave. Dhe meqë zinxhiri midis dy byzylykëve ishte i shkurtër, filloi t'ia tërhiqte me forcë krahun tjetër, për t'ia fiksuar hallkën te kyçi. Atë çast, teksa byreku binte si brumë fiku, u dëgjuan ca kërcitje. Dhe disa klithën, ia theve, ia theve krahun! Mirëpo, në të vërtetë, s'u mor vesh çfarë kërciti ashtu, sepse buzë trotuarit frenoi një makinë gjithë krëkëllimë.

Ishte e natyrshme që të pranishmit të habiteshin. Çfarë donte aty karrotreci me atë vinç aq të fuqishëm ndanë kabinës, sa mund ta shkulte zgubthi gjithë çadrën e cirkut?! Mirëpo tash që e kishte kaluar fazën e falimentit, togeri s'mund ta lëshonte veten dhe të bëhej qesharak në sytë e gjindjes. Nën një mbikëqyrje të kujdesshme, që të përdorej forcë sa më e arsyeshme, pasi ia lidhën vjegëzat në trup, vinçi e kaloi klounin në karroceri. I shqetësuar se çfarë mund të ndodhte rrugës, doktori vendosi ta shoqëronte, çka ngjalli dyshimin e menjëhershëm të Isuf Çaush Matrallozit. Po sikur ky horri të jetë ndonjë bashkëpunëtor i palaços dhe këtë skenë ta kenë kurdisur kastile për të ma nxirë faqen mua?! Po sikur, me t'u nisur, të stisin rrugës gjithfarë gjestesh e ngërdheshjesh duke imituar krerët e shtetit, çfarë do të thoshin shefat për mua?! Ata do të thoshin se jam sylesh dhe mendjeshkurtër, sepse cirkun e izoluar në çadër e ktheva në skenë shëtitëse nëpër qytet.

Nën shkasin e masave të sigurisë, Matrallozi e urdhëroi kamionistin që dy *subjektet* t'i lidhte së bashku me kavo të shtrënguara në katër cepat e karrocerisë, në mënyrë që të mos kumbiseshin anash, as t'i merrte

turri përpara, kur të përdoreshin frenat. Si hipi vetë në kabinë, megjithëse përshëndeti me dorë, e la të shushatur gjindjen, sepse nuk tha ku po e degdiste bashkëqytetarin tonë të kallkanosur. Do ta shtronte në spital, do ta përcillte në shtëpi, apo do ta çonte drejt e në varreza?

Këtë nuk e mësuan as gazetarët, që tashmë kishin arritur në vendngjarje. Vetëm kamera e BiBo TV-së mundi të kapte drejtpërdrejt një plan të gjatë, duke ndjekur karrotrecin që largohej, teksa era frushullonte në kolonën zanore.

DANIELI 5: Në studio po ndihesha si në gjemba dhe në vend të dizajnoja reklamat e porositura, u dhashë pas globit dixhital. Prej disa javësh më kishte hipur një trill që, duke marrë parasysh çarjet tektonike, zonat e akujve dhe të rërës, shpërthimet, përmbytjet, thatësitat dhe zjarret, ta përfytyroja ndryshe nga ç’e tregojnë hartat e sotme. E kisha nisur me Pangea-n, kur Toka ishte ende e pandarë, pastaj ia kisha dalë ta ndaja në nëntë kontinente. Por prapëseprapë më ndiqte një ndjesi mungese, që më linte të pakënaqur.

Si zor ta gjeja ato çaste ku isha treguar dorështrënguar me rruzullin. Prandaj, për të fituar kohë, bëra një prerje të qytetit tim dhe u përpoqa ta vendosja gjetkë. Po ku, ku? pyesja veten, sepse ma tërhiqte vështrimin boshllëku që kishte mbetur nga shkulja e Horketës, ashtu si edhe mëdyshja që, nëse doja ta bëja trambë me ndonjë qytet të huaj ndokund, a do ta kisha miratimin e tij? Pa bërë qyqarin, e lëshova diku në rrafshinat e paana portokalli, duke sjellë në vend të tij një qytet nga kontinenti i ri i Iberisë.

Horketa jonë ishte ende në shkretëtirë, kur më ra zilja e telefonit. Në klasën ku mësonte im bir, po ndodhte një çudi. Mësuesi i matematikës, i cili sapo kishte zgjidhur dy tipa ushtrimesh, mund të fliste e mund të shkruante, por këmbët kaq i qenë mpirë, sa nuk largohej dot nga dërrasa e zezë. Çfarë të bëjmë, babi, të njoftojmë drejtorin e shkollës apo togerin e bashkisë? Në tym me vetveten, i thashë të njoftonin repartin e zjarrfikësve.

Më pas, duke qenë se ngrirja e gjymtyrëve po jepte shenja të përhapjes, sinjalet e telefonit nuk do të reshtnin. Lajmet, shoqëruar me foto të frikshme (disa prej të cilave Selfie), po përhapeshin me shpejtësi në Internet. Në profilin e tij në Facebook, vonë në mbrëmje, mjeku Vilson Karapici do të pranonte se gjatë asaj dite kishte ndjekur njëmbëdhjetë raste: “Po konstatoj paralizë të përgjithshme dhe parciale”, shkruante ai, “ngrirje me afat të papërcaktuar ose vetëm të çastit. Kur i sheh horketasit me një krah, një këmbë apo vetëm qafën e ngurosur, të ngjan sikur këtyre fatkeqëve sapo u kanë injektuar shampanjë në vena.”

- Çfarë ciniku! - vërejti Sara Çesku, duke e ndarë me mua përshtypjen në telefon. - Me gjasë, doktori ka dashur të thotë ujë të gazuar. Por atij horrit te shampanja dhe uiski i fle mendja. Do t'i bëj një koment për këtë lajthitje.

Si mbaroi dita e parë, shkoi nata e zbardhi drita, sado që shenjat mund të mos shiheshin me sy, gjithandej ndihej një si afrim katastrofe. Tërë laboratorët e shëndetit, duke përfshirë shërbimin publik e privat, morën kampione gjaku për analiza. Dy prej tyre, të profilizuar për sëmundjet infektive, morën gjithashtu kampione pështyme, feçe dhe

urine. Por nuk mbetën prapa as laboratorët e veterinarisë. Synimi ishte të gjendej sa më parë origjina e sëmundjes dhe të përcaktohej natyra e saj, ishte virusale, mikrobike, alergjike apo misteriozisht shpirtërore. Por megjithëse specialistët nuk folën publikisht, një burim i Gafilit pohoi se nuk qullepsën gjë, shkaku i paralizës mbetej i panjohur.

Nuk i ndihu zbulimit as ngulmimi për të mbledhur info nga pacientët. Kujt i kishte ikur goja, ishte e pritshme të mos fliste. Por edhe horketasit, të cilët kishin kaluar ndonjë ngrirje gjymtyrësh, pas kalimit të krizës nuk mbanin mend asgjë. Madje dukeshin vërtet pa dije, sepse jepnin thuajse të njëjtën përgjigje, seriozisht e ke, më zuri ky taksirat edhe mua?! Dhe kur u thuhej çfarë u kishte ndodhur, shtonin gjithë mosbesim:

- Je në vete? Ik, or malukat, mos bëj hajgare me mua!

Veçse kushedi përse, duke dyshuar se do të mbërrinin me vonesë atje ku ishin nisur, rrugës bënë ndonjë telefonatë, duke u kërkuar ndjesë atyre që i prisnin. Ec e merre vesh, e kishin apo s'e kishin sensin e kohës që kishin humbur gjatë ngërçit.

DANIELI 6: Erdhi mbrëmja, erdhi dhe mëngjesi, filloi dita e gjashtë e misterit. Të nesërmen ishte ditë pushimi, s'mbaj mend ç'festë zyrtare binte. Dino Jaupi, klouni i cirkut, e kishte marrë veten. Veçse kishte mbetur me cen në qafë. Kur takoi Aranit Lumbardin në barin e Alma Palmës, iu drejtua me këto fjalë:

- Lartmadhëri, para disa vitesh në rrethinat e Horketës u panë ca shpendë shtegtarë, që kishin humbur rrugën. Ata do të rrinin pak kohë mes nesh dhe do të

largoheshin. Por gjahtarët tanë i vranë këta emigrantë. Mallkimi fle sa fle, me gjasë, aq sa duket se është zhbërë. Por pastaj zgjohet dhe shfaqet. Ja ku i ra mbi krye Horketës tani, Madhëri!

Lumbardi nuk pati dyshim në singeritetin e tjetrit. Veçse një qafëngrirë, që s'e lëvizte dot kokën anash, përse po e kthente kohën kaq mbrapa, duke shfaqur frikë nga e kaluara? Pastaj tha me vete: “Si për të ma kujtuar mallkimin që edhe unë i pata bërë Horketës!”

Megjithatë, Lumbardit i dukej se burimi i mallkimit, shi ai për të cilin nuk flitej, thua se donin ta mbanin me zor të fshehtë, ishte më aktual e më flagrant. Mu pas kufirit me Vitistanin, atje ku pllaja krijonte kreshtë dhe niste toka e rrëmbyer, kishin mbetur prej muajsh një turmë refugjatësh nga Lindja e Mesme, të cilët mëtonin të gjithë se ishin sirianë dhe irakianë. Ata donin ta kalonin atë kufi dhe të hidheshin në Horketa, ta vazhdonin udhëtimin drejt Hamivurgut bregdetar, derisa të mbërrinin në vendet e Europës perëndimore. Por urdhri ishte kategorik, të ndalohej medoemos ky rrugëkalim, duke e mbajtur kontingjentin në kamp si bagëtinë në shtrungë. “Hej dreq”, murmuriti Aranit Lumbardi, mbreti i shfronësuar, “është e mundur që në raste të tilla të bëhet besëtytë edhe një kockë e fortë si unë?!”

Por dukej sheshit se në qytet gjithsecili po shqyrtonte sjelljen e vet. Sidomos të prekurit nga paraliza. Çuditërisht, këta po i brente mëkati i fundit që kishin bërë. E cili kishte qenë? Dikush u kishte thënë prindërve fjalë të rënda. Një tjetër, përveçse kishte shkëllmuar të atin, kishte rrahur edhe të shoqen. Ndërkohë që një zonjë kishte

gjuajtur burrin me tigan, ciceroni i Muzeut të Dyllit ishte gëzuar për aksidentin sakatues të rivalit, atij të Muzeut Etnografik. Zonja Dida S. kishte bërë shkelje kurore. Një nëpunës i bashkisë kishte marrë rryshfet, ndërsa një firaun besonte se i qenë ngrirë dy krahët, ngaqë kishte shitur për skrap bronzina të vjedhura në varreza. “Kallkan iu bëftë tërë trupi!”, nëmnin hajdutin andejkëtej. Sepse në traditën zakonore të qytetit, dhunimi i varreve ishte më i pafalshëm se krimi i vrasjes.

DANIELI 7: Por as Karapici s’po i shpëtonte brengës. Atij i dukej se dita e parë e sëmundjes kishte nisur ters për shkak të tij. Ca prej kënaqësisë së vet dhe ca nën trysninë e së shoqes për manifestimet e bulevardit, doktori ishte mësuar ta këmbente shpesh qenin e shtëpisë. Çonte në dyqan atë që kishte dhe merrte një që s’e kishte pasur. Niqifori, tregtari syvëngër, kishte rënë në hall dhe si me të qeshur njëherë i tha: “Doktor, kështu si e keni nisur ju, me të hollat që keni blerë qenin e parë, po m’i blini të gjithë qentë e dyqanit!”

Mirëpo ditën që do të fillonte sëmundja, u kthye pa kapërcyer as pragun, sepse lexoi njoftimin në xham: “Qeni që blihet nuk kthehet.” Dhe meqë tersi ndjell tersin, iu bashkua rrugës edhe togeri, i cili sapo kishte dalë nga gjellëtorja “Nëna Zade”, ku kishte ngrënë supë pule me ofertë. Pa ditur si do të ulërinte më pas, i mahnitur se si mund të kishte ofertë për supën e pulës, Karapici kishte lëshuar një batutë: “E keqja gjen të keqen, turpi turpin!” Dhe Edor Egro, koreografi i Qendrës Kulturore që po kalonte andej, i habitur për kujtesën e

fortë të doktorit, i cili kishte qenë vetëm spektator në atë shfaqje teatri, ia priti:

- Rikardi III, akti i katërt.

Kjo kishte qenë pjesa ku Lumbardi kishte luajtur Mbretin.

Doktori do t'i fillonte klithmat në karrocerinë e karro-trecit. Kur kamioni doli nga Lagjja e Malësorëve dhe në luginën mes kodrave u shfaq oxhaku industrial, që nxirrte re tymi, ai pati një parandjenjë të tmerrshme. Ç'i thoshte mendja togerit, përse po e çonte klounin në fabrikën e konservave, ku ndodhej kaldaja më e madhe e Horketës?! Mos pandehte, siç kishte dëgjuar në vendngjarje, se ai fatkeqi me të vërtetë ishte bërë dru e kërcu?! Mos po merrte përsipër që me anë të furrës t'i binte krejt shkurt, duke shmangur shpenzimet e pamerituara të homazheve dhe të funeralit?! Apo aq mizore ishte urrejtja për kundërvajtjet e përsëritura të cirkut, sa në vend të kurdiste ndonjë aksident për t'i vënë flakën çadrës, po kërkonte të bënte hi e pluhur njërin prej artistëve më anësorë, të cilin prej makijazhit të rëndë në skenë, kur ndodhej në rrugë pakkush e njihte?! Karapici e pushoi ulërimën vetëm në oborrin e fabrikës, sapo kamioni ndaloi para ca arkave me qelqe, sepse aty mori edhe shpjegimin e togerit.

- Fort tuhaf je, doktor. Ti pandehe se ky Matralloz mund ta fuste artistin në kavanoz?! Unë, thjesht, mendova mos këtij qesharakut i kishte ngrirë gjaku dhe desha t'i bënim një banjë avulli.

Po unë, kisha unë turbullimet e mia? Teksa mendoja si dëshmitar për shfaqjen e sëmundjes ditën e parë, lëmsh më bëheshin mendimet. Tri brenga s'më shqiteshin. E para

më vinte nga jashtë. Ajo kishte të bënte me paragjykimin historik mbi Të Keqen. E zë vërtet e keqja të keqen, siç e zë turpi turpin? Ku kishte ndodhur e keqja dhe turpi më parë? S'di përse, nuk më vinte ta besoja që tërë ai agresivitet, me të cilin po përballeshim, ta kishte fillin drejt e në Horketa.

Brenga e dytë më vinte nga brenda. Ç'ishte ai trill i pashpjegueshëm, që më shtynte ta përpjesëtoja globin, duke krijuar ndarje e kufij të rinj? Përse më pikëllonin zonat shkretinore, zonat akullnajore, zonat e shpërthimeve, të katastrofave dhe humbjeve të pashlyeshme?! Tashmë kisha arritur në formatin e dhjetë. Sipas këtij versioni, për të përmendur vetëm një pamje të pjesshme, Gjermania kurrë më nuk do të mund ta sulmonte Francën nga toka, sepse ajo ishte kufitare tokësore me Britaninë, me të cilën krijonte një kontinent ishullor më vete. Po si do ta quaja kontinentin?

Gandimin e tretë e ndjeva mbasditen e asaj të kre-mteje, kur u kujtova se Horketën e gjorë e kisha lënë të flakur midis dunave afrikane. Po sikur të kalonte rrugës Lartmadhëria dhe, duke i parë të ngritura qepenat e studios, të kthente për pak kohë? Çfarë do të thoshte ai, po ta pikaste Horketën në shkretëtirën përvëluese?

- Ke hyrë në gjynah deri në fyt, Daniel. Të paktën, për fat, kjo sëmundje po shfaqet pa zjarrmi. Ç'dreqin ke që ia ndjell me rërën e nxehtë?!

Ndoshta kështu mund ta shprehte mospajtimin ungji.

DANIELI 8: Me gjithë spekulimet që bëhen, Aranit Lumbardi nuk është ungji im, por i tim biri. Ne ishim miq aq të ngushtë, sa në sytë e babait të Aranitit,

taksidarit pensionist Pjetër Lumbardi, mund të kishim qenë edhe vëllamë. Madje ai e dëshironte një vëllamëri mes nesh, çka merrte përsipër ta organizonte vetë sipas ritit më zakonor, duke këmbyer nga një pikë gjaku në potirët e rakisë. Por ne e kundërshtonim me shakanë se kishim lindur për t'i pirë dollinë njëri-tjetrit, jo gjakun si kanibalë.

Kur vuri pasuri Araniti, para apo pasi u bë Mbret në skenën e Qendrës Kulturore? Duke qenë moshatarë, studimet e larta i mbaruam në një vit. Por ai, i financuar nga i ati, bleu prona të patundshme kur shiteshin badihava, pastaj i shiti mbasi çmimi hipi shumëfish. Kështu, kur unë u bëra me djalë dhe kisha një kredi për studion, ai ishte beqar. Edhe beqar, edhe pronar. Përveç të tjerave, ai kishte në pronësi fabrikën e përpunimit të produkteve të bletarisë. Në mos për kurrgjë tjetër, Horketa ishte e famshme për mjaltin, ashtu si për shegët dhe mollët e saj.

Me gjasë, në këtë status ndodhej kur iu propozua edhe skeptri. Në atë kohë teatri amator, që nxitej kryesisht nga pasioni, sponsorizohej pa vështirësi. Regjisori kishte ndjekur dikur një festival të teatrove amatore dhe, qysh atëherë, i kishte mbetur pikë në zemër. Kështu që, një ditë prej ditësh, i shkrepri në kokë: “Përderisa Fifara guxon të luajë Hamletin, përse Horketa të mos luajë Mbretin?!”. Dhe zgjodhi “Rikardin III”. Aranit Lumbardi u mendua gjatë përpara se ta pranonte rolin e mbretit. Por mbasi e pranoi, nuk i la kohë regjisorit të vriste mendjen, deklaroi se financiarisht shfaqjen do ta mbështeste vetë. Dhe ashtu ndodhi. Pas mbrëmjes së premierës, tragjedia u ndoq për rreth dy javë me duartrokitje. Dhe çfarë ra në

sy posaçërisht, pati spektatorë të shumtë edhe nga fqinjët kufitarë. Për sa u mor vesh, të gjithë ishin të një mendimi: Lumbardi nuk dallohej për plastikën, por për zërin dhe energjinë e lëvizjeve. Madje edhe batutat, që një monarku i shkonin në qëndrim statik, ai i thoshte duke lëvizur. “Këtij Mbretit tonë s’i rri bytha rehat!”, do të shprehej doktor Karapici, kur të flakej nga Komiteti i Shpëtimit.

Atëherë, gjatë jehonës që pasoi, mbreti gjeti edhe mbretëreshën e tij. Shì në Qendrën Kulturore. Jo brenda trupës së teatrit, por asaj të baletit amator. Ndoshta gabohem, në atë kohë dancohej “Zogjtë e Parajsës” ose “Fluturimi i fluturave”. Sara Çesku kishte partner Edor Egron, baletmaestrin profesionist, që ishte gjithashtu nëndrejtor i institucionit. Sipas disave, më tepër se në skenë, çifti e kishte gjetur parajsën prapa kuintave, ku putheshin shpesh, por sidomos në dhoma të mbyllura, ku palloheshin herë pas here.

Kur u bë celebrimi, unë kam qenë njëri nga dëshmitarët. Tjetri ishte një ministër, që erdhi në Horketa kastile. Lumbardi kishte qenë bashkëstudent me ministrin, kishin fjetur në një dhomë dhe u kishte ndodhur të ndanin përgjysmë një hamburger. Gjatë ceremonisë, teksa ndiente rrezatimin e Sarës, ai pati një shtrëngim të buzëve.

- Miku im, pse të vjen me qeshë? - e pyeti dhëndri.

- Se ti po merr një mbretëreshë, - ia ktheu dëshmitari.

Zoti e di si ra në dashuri Lumbardi dhe çfarë tmerri (ferri) i shkaktoi skifterit, duke ia shkëputur nga thonjtë atë pëllumbeshë. Shpjegimi i Fanida Rushanit, që përkrahej nga shoqet e saj, se ky paskësh qenë destini i çiftit, përderisa edhe babai i Sarës quhej Pjetër, njëlloj

si babai i Aranitit, më dukej zero me bisht. Shpjegimi i vërtetë mbetet sekret i dy burrave me Sarën midis tyre.

Por a do të kishte sekrete të tjera, nga ato përjetësisht të pazbuluarat, kur nën diktatin e rrethanave çifti do të ribashkohej për të dancuar sërish?

DANIELI 9: Me gjithë besimin e pamohueshëm tek unë, kishte gjëra për të cilat ungji nuk më hapej. Kishte të tjera që më zbrazej. Dhe prapë ca të tjera, dufe të forta, të cilat nuk ia mbante mideja, por i zbrazte mbi këdo që i dilte përpara. Kur merrte një vendim, mund t'i dëgjonte gjithë sa ishin kundër, se mendimi është fushë abstrakte, thoshte. Por s'i honepste ata që vepronin kundër kahjes së tij. Nëse më duhet të ndalem, sepse murit me krye nuk i bihet, më kishte thënë njëherë, unë s'mund t'i lidh duart ndaj atyre, që kërkojnë ta përmbysin murin mbi mua.

Më vonë, kur regjisori i kërkoi Lumbardit të luante Jul Cezarin, madje pa shpenzuar asnjë kacidhe, ai ia ktheu: “Më mjafton mbretëria. Nuk dua ta teproj duke u bërë Perandor.” S'jam i sigurt nëse kjo ka qenë përgjigjja e tij, apo e sajuan të tjerët. Mua më tha vetëm kaq, s'ia kam më ngenë teatrit, Daniel. Tashmë, ç'është e vërteta, edhe kujtesa e rolit të tij të vetëm skenik ishte duke u shuar.

Por kishte qenë zbehje e përkohshme. Me sa duket, aq thellë ishte rrënjosur energjia e Rikardit të tij, sa me t'u krijuar rasti, kujtesa e Horketës e nxori menjëherë në sipërfaqe. Kur ungji u zgjodh kryetar i bashkisë, qytetarët e parë që e takuan, në vend t'i flisnin me zoti Lumbardi, thuajse pa vetëdije iu drejtuan me Madhëria e Juaj. Për

shkak të emocionit, që ma shpërqendronte vëmendjen, unë s'jam në gjendje ta dëshmoj, përderisa s'i kam dëgjuar me veshët e mi. Por ka që thonë se po ashtu, në mitingun e përshëndetjes, fjala e tij ndërpritej nga brohorimat “Rroftë Mbreti!” dhe “Nderime Lartmadhërisë!”

Kurse çfarë ndodhi në mbledhjen e parë të Këshillit të Senatorëve, siç i quanin anëtarët e këshillit bashkiak, u dëshmua edhe në ekranet televizive, edhe në gazetat e ditës. Ka gjithfarë hamendjesh përse kryetari i senatorëve përshtati rregullin anglez për mbretin. Pak para se Lumbardi të hynte në sallë, u dëgjua një zë që thirri: “Hapeni rrugën! Po vjen Qeveritari i Horketës!” Ca thonë se ishte një shprehje besnikërie, ca vetëm një surprizë miqësore, ca të tjerë shohin në atë gjest flukset e mistifikimit, që në qytetin tonë u bëhet gjithnjë prijesve politikë.

Sidoqoftë, ungji ende ndihej i tërbuar, kur doli nga Uestminster-i i Horketës. Por kryetarit të këshillit senatorial, pra atij të senatorëve, i shfreu sikur të ishim në Francë: “Unë nuk jam jakobin dhe s'kam pse t'ia pres kokën mbretit. Por as rri duarkryq, derisa të ma presin kundërshtarët. Kam dhënë urdhër që kurrën e kurrës të mos përsëritet kjo farsë. Kuptove?! ”

S'kishte shumë për të kuptuar, mjaft të çoja nëpër mend se shumicën e këshillit e kishin fituar opozitarët e tij politikë. Prandaj desha ta ndërprisja, kur u ndodhëm vetëm për vetëm dhe, sado me ton të ulët, ia nisi prapë me “kurrën e kurrës”. Mirëpo kësaj here e kishte me mua. Po thoshte se kurrën e kurrës nuk mund t'ia lejonte vetes të më punësonte si rrogëtar në bashki, duke rënë në

konflikt interesi. Veçse pikërisht prej miqësisë që kishim, m'u lut t'i qëndroja në krah.

DANIELI 10: Me këtë kokë që kam, do ta ndryshoj Horketën. Por ndryshimi fillon prej këtij institucioni. Kur ta vëzhgojmë godinën nga jashtë, mendo si artist për bashkinë, Daniel, se është fytyra e qytetit.

Tashmë fliste duke i ardhur rrotull kabinetit dhe duke rrufitur hundët, si për të vënë në provë nuhatjen e tij. Dhe vërtet, sidomos nëpër qoshet ku s'binde drita, aty vinte një si erë uthulle, thua se gjithçka prej druri ishte në kalbje e sipër. Kupton, miku im? Me shijen tënde bëhu zbatues i urdhrave që jap, vazhdoi. Nën këmbët e mia dua një dysHEME tjetër, jo këtë që kërcet. Dhe tjetra të jetë e lëmuar si vetë qielli. M'i hiq, m'i hiq prej syve këta kolltukë. Forma e tyre tip fisheku ndjell gjumë. As ndenjësën time, me shpinoren e hapur si bisht palloi, nuk e dua. Kjo karrige frymëzon krenari boshe. Por mos harro tryezën e punës. Pa shih këtu, mua ma shpifin këto këmbë në formë sparkate. Të paktën, tryeza duhet...

Po më bëhej se nuk isha më aty, ngase pa e ditur prej kah më vinte përfytyrimi, vazhdova me vete: "Tryeza duhet të ketë katër radhë gurësh. Në të parën një sardino, një topaz dhe një smerald. Në radhën e dytë një bruz, një safir dhe një diamant. Në të tretën një hiacint, një agat dhe një ametist. Ndërsa në radhën e katërt një grisolit, një oniks dhe një diaspër. Këta gurë do të ngadhmohen në rrathët e tyre të artë..."

- Këtu, këtu Daniel, ku e ke mendjen?! - ndaloi një çast ai.

Mos kisha folur me zë? Mos isha nën tryshninë e bisedave biblike me Atë Kurjelin? Por kur ishin bërë bisedat, në të shkuarën që vjen apo në të ardhmen e shkuar? Më ndryshe, përpara apo mbas sëmundjes në Horketa?.. Në të vërtetë, Lumbardi po më thoshte se donte një tryezë të rëndë, me këmbë të drejta e të forta. E di se, kur të vonohem mbrëmave dhe Sara të vijë për të më marrë, asaj do t'i shkrepë të kërcejë në atë podium. Për të ma hequr lodhjen e ditës, balerina ime kështu bën herë-herë edhe mbi tryezat e shtëpisë.

- Çfarë ke që hutohesh, Daniel?! Nuk jam duke folur për Pektoralin e shenjtë.

E kuptova se edhe ungi po kujtohej për Dhiatën e Vjetër. Sidoqoftë, ia njihja atë aftësi, i mjaftonte një vështrim i përqendruar për ta nuhatur çfarë kishte tjetri në kokë. Dhe unë kisha në kokë pajtimin me detyrën. Për ca kohë do të bëhesha njëfarë Jozeu, që njihet si zbatues i porosive të Moisiut, aq sa edhe kur u ngjiti në malin e Sinait, e mori me vete.

Por s'do të vononte shumë që ky rol të ndërpritej, veçse pa e prishur as miqësinë e tij dhe as biznesin tim.

DANIELI 11: Çfarë m'u desh të bëja? Ungji kërkonte që, në bashkëpunim me kryearkitektin e bashkisë, të hartonim sa më shpejt projektin e restaurimit të godinës dhe t'ia paraqisnim preventivin. Ai tha se shpenzimet do t'i mbulonte me tri burime. Dhe ashtu doli. Nga ish-ministri, që tashmë ishte bërë Kryeministër, siguroi një grand për fasadën dhe shtesën ndërtimore. Punimet e brendshme i mbuloi me donatorë të qytetit. Ndërsa

pajisjeve për kabinetin u doli për zot nga xhepi vetjak, a thua se në fund të mandatit do t'i çonte në vilën e tij.

Arkitekt Serian Draçini tregoi përkushtim të çuditshëm, si të mos ishte fjala për një ndërtesë të zakonshme, por për një tempull të vërtetë. Disa imazhe të planimetrisë së re atij sikur i vinin nga e ardhmja, thua se donte ta ndalonte sëmundjen që do të pllakoste në qytet. Por, duke qenë në prag të pensionit, ndoshta i vinin edhe nga e kundërta, egoja e tij për të realizuar një formë, që kurrë më s'do t'i jepej rasti si arkitekt.

Si u morëm vesh për tërësinë e projektit, i cili ngjalli ambicie profesionale edhe tek unë, i lamë shoshokut dorë të lirë. Gjithë dekorimi më mbetej mua. Po përmend, bie fjala, porosinë e Lumbardit për dyshtemenë si vetë qielli. Hajde jepi dum kësaj kërkesë abstrakte, që gjithsesi nuk mund ta merrja shqeto metaforë. Por, afërmendsh, as me safirë s'e shtroja dot, për të zëvendësuar parketin e kalbur. Atëherë vajta në bregdet me një shpurë punëtorësh, mblodha atje gurë xhami dhe kompozova në dyshteme një mozaik që, kur i binte dielli nga dy baxhat e çatisë, reflektonte një dritë të kaltër. Vërtet jo aq të pastër sa në qiejt e lartë, por deri aty ku nuk arrijnë pluhuri dhe smogu. "M'i grive shojet e çizmeve, Daniel", qeshte Sara. Sepse, kur shkante për ta shkullur të shoqin mbrëmave dhe ndodheshin vetëm në kabinet, ajo nuk kërcente mbi tryezën e rëndë me këmbë të drejta, por mbi mozaik. "Nuk janë çizmet, është diva e Horketës që po i grin perlat e detit!", më shpëtonte goja mua. O Zot, si ishte Sara! Fanida Rushani kishte përhapur njëfarë opinionit, që u bë disi gjithëpërfshirës. Në qytetin tonë, thoshte

nënolja, burrave s'u gjen shpirti rehat, në vend të grave të tyre ëndërrojnë Mataharin në shtrat. Nofka në këtë rast ishte rastësore, pasi për Sara Çeskun mbizotëronte nofka Saraçineska. Kalimthi po kujtoj edhe paralajmërimin që më bëri ime shoqe për gruan e ungjit, duke shfrytëzuar tallazin e qerpikëve: "Kujdes, Daniel, ki mendjen në kokë! Një herë ta luan syrin Sara dhe të hedh përtokë."

Të parët që e pikasën planimetrinë e re të bashkisë, atë në formën e një kryqi, ishin udhëtarët që e panë nga lart. Kompania kryeqytetase Air Sprint bënte çdo javë pesë fluturime me helikopter, duke e mbajtur rregullisht linjën Tiranë-Horketa dhe anasjelltas. Por i pari që ia shtiu në vesh Lumbardit, ishte Jaho Juba. Ndërtesa tani kishte në ballinë një portik të lartë sa dy katet, me kolona dhe me pediment, ndërsa po në atë drejtim, mbrapa i qe bërë një shtesë sa volumi i portikut.

Pasi foli Juba, ungji më thirri menjëherë për një verifikim të përbashkët. Në mirëbesim, as që deshi të hynte në hollësira, prandaj nuk pyeti për girlandat me lule dashtre, enën e burimit jetëdhënës, rozetat me tërfil katërpletësh apo simbolikat *a secco* në muret e tremës. Vetëm kur vërejti mbi kulmin e pedimentit një figurë, që e futi në mendime, tha:

- Po ai kryq atje?

- Nuk është kryq, - thashë, - por figura e thjeshtuar e një qytetari me krahët e hapur. Është figurë që tregon katër pikat e horizontit. A nuk jemi të rrethuar nga katër fqinjë?

Dhe ndonëse isha në fushën e spekulimit (Më fal, ungji im!), si të më kishte transferuar arkitekti edhe mua në të ardhmen, vazhdova gjithë sinqeritet:

- Shiko qendrën, zoti Lumbardi, aty në qendër është Horketa. Përfytyro tani sikur pika ku priten drejtëzat të jetë e verbër. Pra, të mos mund të shohë as lart dhe as poshtë, as djathtas e as majtas. Çfarë do të thuhet atëherë për Horketën, çfarë do të ndodhte me qytetin tonë? Ajo shenjë tregon se kjo ndërtesë është e hapur për bashkësinë e qytetarëve dhe njëkohësisht dëshiron hapjen ndaj Të Tjerëve.

Pandeha se nuk e pranoi interpretimin tim, ngaqë ma hodhi dorën në shpatull, si për të ma lënë mua kryqin në kurriz. Por s'e kishte zakon t'i shprehte falënderimet me tepri. Dhe meqë ma kishte shprehur mirënjohjen më parë, tha diçka për strukturën e ndërtesës, për ta kaluar fjalën te Seriani.

- Ky arkitekti ynë e paska të përpiktë edhe strukturën e arsyetimit, Daniel. Eja, - shtoi pastaj me nxitim, - ata po na presin.

DANIELI 12: Arrita ta ndiqja nëpër shkallë deri në kabinetin e tij. Po kush na priste atje? Ishin katër donatorët biznesmenë, të cilët i kishte ftuar të mbrëmshmen për darkë në Alma Palma, ndërsa kafën e kishin lënë ta pinin në zyrën e Lumbardit. Por tash nuk ishin të ftuar, ishin të thirrur. Ai u tha hapur, i kishte thirrur për tenderat që bashkia do të shpallte së afërmi. Dhe këtu vihet kuti midis mirënjohjes e bukëshkalit, sqaroi.

- Jajuba, - i thirri pastaj nëpunësit të tij, - kujdes për çfarë shkruan në Procesverbal. Jam duke folur me parimin e Lagjes së Malësorëve, - qeshi.

Nuk dihej tamam nëse ishin mbushur a s'ishin mbushur dyqind vjet, qyshkur ca malësorë u vendosën me urysh në ato faqe kodrash. Por duke lënë shtëpinë e plëngun në malet veriore, ata morën me vete mustaqet dhe zakonet. Më pas, gjithë sa ndërtuan aty edhe vendasit, mori emrin e malësorëve. Madje qysh prej asaj kohe, ashtu si për bletët që të ardhurit i patën sjellë me vete, traditat e tyre ndikuan në disa marrëdhënie njerëzore. Araniti në atë lagje ishte rritur, vonë e kishte bërë vilën në zemër të qytetit. Por shtëpia prindërore, ajo e Pjetër Lumbardit, ende në kodër ishte, me qilarët në katin e parë dhe dy kate sipër, ndërtuar me gurë të latuar.

- Shëno, Jajuba, - i foli nëpunësit përsëri, por kësaj here me shikimin nga donatorët. Dhe atyre iu drejtua: - Kanuni i Maleve nuk njeh shtojcë fitimi. Kanuni njeh hua të thjeshtë, sa më dhatë kam me ju dhënë. Dhe juve do t'ju jepet mbasi ta kryeni punën e të jetë bërë supervizioni. Kjo është marrëveshja. Tani pihet kafja. Ju s'keni ndonjë kundërshtim për...

Unë pandeha se do t'i pyeste për marrëveshjen, por këtë e quante të mbyllur. Prandaj pyeti: Ju s'keni ndonjë kundërshtim për kafen?

Për një marrëveshje të prishur me Kryeministrin do të jepte dorëheqjen njëmbëdhjetë muaj më vonë. Tërë atë kohë, sa herë e ndeshja rrugës, fliste me njëfarë dihatjeje, thua se i shkonte dita duke ngarendur gjithandej nëpër qytet. Kur dha dorëheqjen, unë u ndodha në Detroit, i ftuar nga një shoqatë e Artit të Rrugës. Por atje e mora vesh, teksa vlonin thashethemet e horketasve në rrjetet sociale. Unë as guxova t'i telefonoja, as ai s'më telefonoi.

I dërgova një mesazh në WatsApp, e lexoi a s'e lexoi nuk mora përgjigje. Arsyen e dorëheqjes e mësova më vonë, por le ta rrëfejë mbi bazën e fakteve kush u ndodh në qytet. Më poshtë unë po rrëfej vetëm hamendësimin tim.

Një mbasdite po shëtisnim në rrethina të Horketës dhe, duke vështruar kthesat e lumit, ungji ndaloi.

- E di çfarë më sjellin në mend këto kthesa, Daniel? Më kujtojnë përdredhjet e Senës në dalje të Parisit. Veçse matanë nesh është stadiumi i qytetit. Këtu te gryka e Shënkollit, ku lumi ngushtohet më tepër, do të duhej një urë. Jo pasarelë, por urë që të mbante edhe hekurudhë!

Të ishte prishur me Kryeministrin, mikun e viteve studentore, për urën? Sado i thekshëm ky kujtim, s'po krijoja bindje. Por as më shqitej nga mendja, për shkak të karakterit të Lumbardit. Në çfarëdo që merrte përsipër, ai do të vinte dorë për ta ndryshuar. Madje, pa pyetur nëse do ta gëzonte vetë apo do ta gëzonin të tjerët, s'e kursente as xhepin e tij. Por nëse i duhej ta linte, largohej në një mënyrë të atillë, që dukej sikur i vinte shkelmin.

Sidoqoftë, atje larg isha gabuar me Urën e Shënkollit. Ndërsa me parandjenjën se, po t'i pikaste qepenat e ngritura, ungji mund të kthehej në studion time, nuk u gabova. Veçse nuk ndodhi asaj dite, por si nja dy javë më mbrapa. Mos ndoshta tri?

DANIELI 13: Në tri javë sëmundja e ngrirjes asnjë ditë nuk u ndal. Ndryshe nga fillimi, ato shenjat e katastrofës tani përveçse ndiheshin, dukeshin edhe me sy. Në rrugë mund të shihje gjithfarë ulokësh, disa herë në

poza qesharake, me njërrën dorë lart si të kishin dashur të kruanin veshin në çastin që krahu u kishte ngrirë, ose me njërrën këmbë gjysmë të ngritur, kur kishin qenë duke hedhur hapin. Kishte edhe nga ata që lëviznin me bastun, me paterica apo karroca invalidi. Tregtarët kishin nuhatur kërkesat dhe po e plotësonin tregun.

Nga nevoja për ta thyer disi atmosferën e rëndë, pati qytetarë që imituan lojën e fëmijëve ngrij-shkrij. Fëmijët ndaheshin në dy skuadra, njëra palë ishin ndjekësit, tjetra të ndjekurit. Të parët lëshoheshin me vrap pas të dytëve. Kur ndjekësi prekte një të ndjekur, qoftë dhe me majën e gishtit, ky ndalonte në vend, se quhej “i ngrirë”. Por ama duhej të ruhej nga të ndjekurit, sepse po ta prekte njëri prej shokëve të ekipit, bëhej prapë “i shkrirë” dhe rihynte në lojë. Të rriturit e filluan si me shaka. Ata preknin dikë, i thërrisnin “Ta lashë!” dhe fugonin kuturu. Mirëpo menjëherë lindte pyetja: “Çfarë më la?” Duke dyshuar se sëmundja ishte ngjitëse, tjetri alarmohej nga kjo prekje. Prandaj, sapo një qytetar shihte dikë që ngarendte drejt tij, niste të vraponte edhe vetë për t’u gjendur sa më larg sulmuesit. E jo vetëm ai, por edhe të tjerët që nuk ishin vënë në shenjë, ia mbathnin me të katra.

Pak nga pak, kaq terrorizuese u bë frika, sa edhe në ecjet normale njerëzit kthenin kokën andej-këtej, duke vështruar njëri-tjetrin gjithë dyshim. Cili ishte sulmuesi dhe kur do të sulmonte? Ishte gati si të pyesnin: Cili është kamikazi dhe kur do ta bëjë shpërthimin?

Tashmë ishin të shumtë ata që rrugës mbanin distancë, për t’i shmangur edhe prekjet pa dashje.

Prandaj zoti Mentor Tanashi, i zgjedhur kryetar bashkie pas Lumbardit, e modifikoi qarkullimin, duke hartuar një rregullore të veçantë për këmbësorët. Me këtë rast u bë edhe klasifikimi i rrugëve dhe orareve, rrugë më tepër apo më pak të rrezikshme, rrugë më tepër apo më pak infektuese. U vërejt menjëherë pakësimi i qarkullimit të këmbësorëve, i dyndjeve kohë e pa kohë nëpër kafene, si dhe ndërprerja e shëtitjeve gjatë mbrëmjes. Por, në pritje të një ndeshjeje derbi, nuk u ndërpreu brohoritjet para selisë së FCH (Futboll Club Horketa). Për një fitore me tri pikë, tifozët linin edhe kokën pa frikë.

Nuk u ndërpre gjithashtu as loja me thirrjen “Ta lashë!”. Kjo britmë dëgjohej gjithandej. Një specialist i statistikave, pas një sondazhi, doli me përfundimin se “Ta lashë!” dëgjohej rreth 780 herë në minutë, ndërsa midis lojtarëve kishte të atillë që e përsërisnin mbi njëzet herë çdo ditë. Ndërkohë që dhjetëra mijëra “Ta lashë!” shkonin kot, ndodhte që rastësia të bënte të vetën. Ngaqë çasti i sulmit ishte përputhur me fillimin e sëmundjes, i prekuri ngrinte me të vërtetë. Shì këto raste bëheshin lajm për median dhe, teksa shpërndareshin shtëpi më shtëpi, ia shtonin lojës misterin dhe tmerrin.

DANIELI 14: A nga turri me të cilin hyri, a nga energjia që shpërndante prania e tij, m’u bë se prapa shpinës dëgjova brafullima shkëndijash. I dhashë karriges një gjysmë rrotullimi, ndërsa Lumbardi më doli në brinjë, duke e pasur të lirë pamjen e ekranit. Në ç’përpjestim e kisha globin tani? Me njëfarë sikleti mendova se andej do t’ia niste, prandaj kishte ardhur në studio. Por tha tjetër për tjetër.

- Në Horketa nuk do të ketë derbi.
- Pse nuk do të ketë? - u habita.
- Hamivurgu ka kërkuar që ndeshja të luhet në fushë asnjane. Do të thuash se është e padrejtë?
- Ashtu mendoj. S'ka arsye që Federata t'ua plotësojë kërkesën.

- Shkaku formal nuk mungon dhe Federata do të thyhet. Anëtarët e Zonës Shegan po i bëjnë presion njëherësh. Dhe ata janë superiorë ndaj nesh, katër kundër një.

Nuk e pyeta nga e kishte lajmin. Burimet e tij zakonisht ishin të sigurta. Megjithëse kishin kaluar tetë muaj nga dorëheqja, ai i ruante lidhjet me katër qeveritarët e Unionit dhe këta, në vend t'i telefononin kryebashkiakut Tanashi, herë-herë i telefononin Lumbardit. As ungji nuk e zuri ngoje pasojën për tifozët, sepse merrej me mend. Derbi tradicional pritej prej kohësh. Për tifozët e Horketës ishte njësoj si të mos luante Barcelona kundër Realit të Madridit.

- Çfarë mendon për këtë sjellje? - pyeti. Por përgjigjen e dha vetë. - Tash për tash është vetëm arrogancë, çka Unionit i shkon për shtat nga forca e kooperativizmit. Ta merr mendja ç'mund të vijë më tej? Më tej mund të vijë njëfarë terrorizmi moral, që i bën sus të dobët. Por ky është i vështirë të formulohet e të denoncohet, sepse s'ta pranon asnjë kancelari. Të fuqishmit janë në gjendje t'i tjetërsojnë edhe provat, Daniel.

Mbasi hymë në këtë fushë, s'kisha më nevojë për hamendje, Horketa vetë ishte provë e gjallë. Atë që mund ta bënte një bombardim me lëndë kimike në një zonë luftimesh, po e bënte natyra. Me t'u rritur paniku i sëmundjes, nisi dhe eksodi. Çdo ditë shiheshin njerëz,

duke ngarkuar bagazhet në makina. Disa familjarë, si ta kishin vendosur për t'u shkullur përgjithmonë, kishin porositur kamionë taksì për mobiliat e shtëpisë. Të tjerë mbushnin ndonjë valixhe me rrota, ngarkonin thasë në biçikleta, rrasnin ca çanta në karroca fëmijësh dhe niseshin më këmbë drejt kufirit. Në ato varganë kishte edhe plaka, pleq e njerëz sakatë, por gjithashtu qen e mace, se nuk i linin dot në mëshirë të fatit. Pushteti lokal gjykonte se ishte i domosdoshëm evakuimi i organizuar i fëmijëve, në mënyrë që të mos rrezikoheshin shëndeti i brezit të ardhshëm. Por megjithëse Mentor Tanashi, qeveritari ynë, kishte hyrë në bisedime me autoritetet fqinje, megjithëse kishte dërguar edhe një delegacion në Këshillin e Unionit, përgjigjja prej andej po vonohej.

Thuhej se, para degdisjes, refugjatët binin në mendime për kahjen që do të merrnin. Disa e vendosnin drejtimin mbi shpresën se matanë kishin ndonjë njeri të familjes, ndonjë kushëri a të njohur. Disa flitej se hidhnin fall, të tjerë duke u orientuar nga vala, ose fare verbazi pa u menduar fare. Mirëpo tekefundit, gati-gati, të gjithë e pësonin njëlloj, linin shi e gjenin breshër.

Kur në sheshin kryesor të Horketës ikanakët e parë thirrën “Nga sytë këmbët!”, sapo mbyllej java e dytë. A thua ajo thirrje u dëgjua në katër anët e horizontit? Ata që u nisën drejt Likavës, me gjithë pengesat, ia dolën. Kurse të tjerët dështuan. Kush u nis drejt Vitistanit, shpëtoi paq pa u rrahur. Një grup banorësh të qytetit fqinj kishin bllokuar rrugën dhe nuk i lejonin të hynin në territorin e tyre. Në fillim u mor si një zemërim i rastit, prandaj diçka

për t'u harruar. Por bllokimet erdhën duke u përsëritur, derisa në pikat kufitare u vunë edhe tabelat STOP.

- A duhen prova të tjera?! - më erdhi t'i thosha Lumbardit.

DANIELI 15: Por ungji i qe afruar kompjuterit dhe, me njëfarë ankthi të përnjëhershëm, i dhashë karriges sërish gjysmërrotullimi. Për respekt ndaj tij m'u desh t'i ndodhesha në krah, megjithëse atë çast do të kisha dashur t'ia mbathja nga studioja.

Tashmë kisha mbaruar punë me globin dixhital. E kisha ndarë në dymbëdhjetë planetë, të cilët hamendësoja t'i quaja me emrat e dymbëdhjetë shenjave të Zodiakut. Po ç'do të thoshte Lumbardi? T'u thafshin krahët për sëpatën që i paske vënë botës! Apo: Vazhdo, vazhdo, sepse është bërë një zbulim, që dymbëdhjetë shenjave të Zodiakut ua shton edhe të trembëdhjetën.

Duke e mbajtur frymën, pashë si e zgjati dorën te mausi dhe, mbasi bëri diku një lëvizje kryq e tërthor, e mbajti kursoren në kryqëzimin e drejtëzave.

- Kur bëmë inspektimin e arkitekturës së bashkisë dhe pikasa atë siluetën e njeriut me krahët e hapur, ti më fole për pikën e verbër. Çfarë deshe të më kujtoje me të verbrën, izolimin? - pyeti. - Diçka e tillë më vjen në mend.

Në çastin që ra heshtja, ndoshta po shtrëngonte muskujt e fytyrës, sepse mollëzat sikur iu bënë edhe më të kërcyera. Pastaj m'u duk se pati një përhumbe, sikur po zhvendosej nga studioja drejt atyre viseve që përfshinte kryqëzimi i drejtëzave.

- A nuk do të bëhej edhe Austria një pikë e verbër, një vend që nuk të çon askund, nëse do të izolohej nga Italia,

Gjermania, Zvicra, Sllovenia dhe Hungaria, fqinjët e saj kufitarë?! Djall o punë, ma çartallose trurin me globin tënd, Daniel!

E ndjeva se do të shtonte diçka, ndoshta atë qortimin që prisja. Por në vend të fliste, nxitoi për të ndryshuar komandat, që ta shihte globin duke u rrotulluar. Pse hiqej sikur s'i vërente rajonet e trishta planetare, rajonet e akujve, rajonet shkretinore, rajonet ku bëhej luftë, rajonet nga ushqehet terrorizmi, rajonet e marijuanës dhe të kokainës, rajonet... Asnjë fjalë as për masakrën që kisha bërë me sëpatën virtuale. Vetëm pyeti:

- Ku e ka pultin e komandimit kjo anije kozmike? Me nder teje, gjithë Fuqitë e Mëdha të Botës i hanë kakën globit, nëse del nga orbita. Ato as mund t'ia rrisin, as t'ia zvogëlojnë shpejtësinë e rrotullimit. Me një fjalë, nuk mund ta kapitalizojnë për ta bërë ditën dyzet orë dhe natën vetëm tetë. Por ato mund ta shkatërrojnë. Përse, ahëre, sillen kaq keq me Tokën?! Madje edhe kryeministrat e vegjël, si soji i mikut tim, firifiu e kanë sjelljen, shtoi te pragu kur do të largohej.

Ishte hera e parë që mbas dorëheqjes ma përmendte Kryeministrin. Ndoshta nga përfytyrimet e çuditshme dhe pyetjet e çuditshme që qarkullonin në Horketa. Hamendësohej sikur sëmundja e paralizës kishte prekur edhe zyrtarë të lartë të ministrive, nëpunës të bankave, investitorë, përfaqësues të FMN-së dhe ambasadorë të huaj. U tha se një ministër e kishte ngrirë sëmundja teksa priste thonjtë. Po sikur ta mbërthente Kryeministrin në çastin, kur po nënshkruante ndonjë marrëveshje me Berlinin? Po sikur Presidenti ynë të kallkanosej në vend gjatë pritjes, pa

mundur të hidhte asnjë hap kortezie, që t'i dilte përpara për dorështrëngim kolegut grek?! Çfarë do të bënte mysafiri, pyeste orëndreqësi farmacistin e rrugës tregtare, do t'ia jepte gazit nga ajo pozë e përçudnuar, do të vihej vetë në lëvizje apo, për shkak të keqkuptimit, do të merrej si skandal diplomatik dhe midis tyre do të ulej trau menjëherë?!

Në të vërtetë, kur nisi java e re, trarët ishin ulur nga të katër anët për horketasit.

DANIELI 16: Rritja e valës së refugjatëve i detyroi autoritetet e Unionit të mblidhnin sërish Këshillin e Kryetarëve. Në rend të ditës u vunë masat për ndalimin e këtij migrimi kaotik. Qeveritari i Vitistanit, ku papunësia matej me dy shifra, ishte kaq i zemëruar, sa bëri propozime të skajshme. U pranua vetëm njëri. Përveçse kaotik, ky migrim do të trajtohej edhe si i paligjshëm. Prandaj u forcua dera e rrethimit për ardhacakët e huaj, që po dyndeshin vazhdimisht. Po si do të bëhej me horketasit, të cilët tashmë i kishin kaluar kufijtë? U la që vendimi të merrej në mbledhjen e ardhshme.

Nga çdo anë të niseshe, dokumentet e para që kërkoheshin në kufi ishin pasaporta biometrike dhe karta e identitetit. Meqë çdo guvernë nuk mbronte vetëm veten, por edhe anëtarët e tjerë të Shëganit, përgjegjësia ishte njëkohësisht kolektive. Sepse me të kaluar një kufi, qarkullimi i lirë bëhej pa kontrolle në tërë territoret e Unionit. Kush kishte pasaportë të huaj, sidozot gjermane apo amerikane, kalonte fjollë. Kontrollat më të rrepta, ato me aparate superspeciale, ushtroheshin për dokumentet vendase. Të lindurit në Horketa, si të ishin

të gjithë të infektuar, ktheheshin pa hyrë në diskutime nëse ishte a s'ishte diskriminim, kishte a s'kishte shkelje të të Drejtave të Njeriut. Arsyetimit të qytetarit: “Unë shihem me sy që nuk jam i sëmurë”, komandanti i postës policore i përgjigjej: “Ti shihesh, por mikrobi nuk shihet! E nga ta dimë ne se tashmë s’e ke marrë dhe, për t’u aktivizuar, mikrobi po kalon periudhën e inkubacionit?! Do të infektosh Sheganin, zotrote?!”

Në fillim, kur Rajoni i Bashkuar shfaqte vetëm shqetësime verbale, horketasit ballafaqoheshin me policinë edhe në qytetin e tyre. Të parët që e detyruan prefektin të ndërmerre atë hap, ishin qytetarët e shëndetshëm. Ata u kapën nga paniku se sëmundja ishte vërtet ngjitëse, prandaj ndoqën instinktin o burra t’ia mbathim sa nuk është vonë! Policia e rendit bënte kontrole në linjat e autobusëve, aty shihnin sa bagazhe kishin udhëtarët, cili ishte qëllimi i udhëtimit, sa të holla kishin me vete, etj. Për ca kohë, rruga më e sigurt e arratisjes mbeti lumi, drejtimi nga Horketa në Hamivurg. Të ndihmuar nga rrjedha, skafet e gomonet, varkat e kanoet shkisnin në ujë. Atyre që arratiseshin ditën, thuhej se u shfaqej para një kolonë resh, për t’u njoftuar cakun kufitar ku duhej të mbërrinin. Ndërsa atyre që iknin natën, u shfaqej një kolonë nga shkëlqimi hënor, që t’u bënte dritë për të vozitur edhe në errësirë. Po të ishin thashetheme, këto s’janë për t’u besuar. Por nëse ishin fanitje, atëherë mund të besohen, pasi çdo eksod, qysh nga ai bibliku, thonë se shoqërohet me iluzione optike.

Por ky shteg, me t’u zbuluar, u mbyll shpejt. Kundër kalimit ilegal Hamivurgu vuri rojat breglumore. Ato

përdornin ca mjete të shpejta lundrimi, që dukeshin si motovedeta të vogla. Kur ndodhte të përmysej ndonjë gomone me refugjatë, skafistët ia mbathnin të parët, ndërsa ata që s'dinin të notonin, rryma i shtynte përpara deri në deltën e detit. Në njëfarë mënyre ëndrra e tyre plotësohej kështu, sepse ata mbërrinin në Hamivurg, megjithëse si kufoma.

DANIELI 17: Ndërkaq, në kufijtë tokësorë turmat e bllokuara po rriteshin. Gjithë ditën nguleshin aty pa lëvizur. Dhe tërë natën pa gjumë rreth zjarreve. Në këtë anë dëgjohej muzika që vinte prej andej, por matanë s'arrinte vaji i foshnjave prej këtej. Kur emigrantët protestonin, duke provuar të ngrinin me forcë traun e rrugës, policia i paralajmëronte me megafon, pastaj përdorte shkopinj të gomës dhe gazin lotsjellës. Megjithatë, të ndërkryerit ia dilnin nganjëherë. Por në anën tjetër nuk i linin të bënin tutje, sepse ndërhyenin edhe Dragonjtë e Forcave Civile, siç e mbiquanin veten trupat paraushtarake të Vitistanit.

Këta trupa të freskëta përbëheshin nga vullnetarë pa uniformë, që për shumë arsye ishin kundër pritjes së refugjatëve. Ata ndihmuan edhe për ngritjen e kampeve, duke hapur çadra e duke montuar baraka. Shfaqja e vinçave këtu nuk ishte një telefonatë e gabuar, si ajo e Matrallozit për karrotrecin. Makineritë u përdorën për kontejnerët. Veçse hynë në punë edhe për tjetër gjë. Kur ndodhte që ndonjërin nga refugjatët tanë, të cilët ishin përzier me refugjatët arabë, e zinte paraliza e pjesshme ose e përgjithshme, po të ishte vetëm, transferimi ajror kryhej

menjëherë. Nëse kishte të tjerë me vete, në fillim e ndanin nga familja, pastaj e shkullnin me vinç dhe, pa e ulur fare në tokë, e shkarkonin në anën nga kishte ardhur. Shi në këtë çast disa protestues bëheshin më të kthjellët. Ata i ulnin tonet, duke u përpjekur ta sqaronin komandantin e postës se kërkonin vetëm rrugëkalim, të shpërngulurit nuk do të bëheshin rezidentë në Vitistanin e tyre, mbasi synonin vise të largëta. Tjetri nuk nxirrte një fjalë. Por, me vështrimin në majën e vinçit, sikur thoshte se mundësia dhe pamundësia nuk vareshin prej tij, urdhrat jepeshin nga lart.

Në këtë situatë, me gjasë, kishte ardhur ora kur as zoti Tanashi nuk mund të bënte më asgjë për qytetarët e tij dhe ndihej i dorëzuar. Një ditë, qeveritari ynë më thirri në zyrë.

- Daniel, mund t'i çosh ungjit tënd një porosi?

- Ai s'është imi, - i kujtova. - Lumbardi është ungji i djalit tim.

- Aq më tepër ahëre, bëje për tënd bir.

- Nuk mundem, - thashë, - sjellja e Lumbardit nuk ma lejon. Por është e udhës t'i shkoni vetë.

Më kishte shpëtuar goja pa dashje? Përse t'i shkonte vetë dhe jo ta thërriste në zyrë?! Ndoshta tjetri as që e pikasi mëdyshjen time. Po atë ditë i vajti në shtëpi dhe Sara, e cila u ndodh dëshmitare, ka pohuar se i tha:

- Madhëri, në duart e tua e ka lënë Zoti qytetin tonë!

Siç e ka zakon, tregonte Sara, im shoq u nxi në fytyrë nga turbullimi. Dhe këtë unë e besoj. Madje edhe symbyllur e përfytyroj me atë pamje. Sa herë ia përkëdhelnin sedrën, Lumbardi binte në sherr me Lumbardin, duke hyrë në ca pështjellime që ia çmerisnin

vijat e fytyrës. Meqë sillej si të mos e donte veten, atij s'i mjaftonte që e donin të tjerët. Por nuk shkonte më tej, për shembull, nuk thoshte: A më do Zoti mua?

Ditën që atij iu hodhën hekurat dhe njëra nga gazetatat nxori në faqe të parë rubrikën Hidh e Prit, pati shumë horketas që ia bënë vetes këtë pyetje. Madje shpesh me ofshamë.

DIKUSH FLET ME ZOTIN, sipas GAFIL

Për të kaluar verën e nxehtë, një fshatari nga Tamarina iu mbush mendja me dalë në bjeshkë te miku i tij. Hodhi në sup një thes dhe u nis. S'kishte bërë as pesëdhjetë hapa kur tre bashkëfshatarë, burra që e mbanin veten si më të mençurit e Tamarinës, e pyetën se ku po shkonte. Si njeri që s'ishte larguar ndonjëherë nga katundi, atij i erdhi zor t'u thoshte të vërtetën, prandaj u gjegj:

- Po shkoj me folë me Zotin, se më ka thirrur vetë.

Atëherë, secili i dha të njëjtën porosi:

- Meqë po shkon, pyete ku më ka mua në ata defterët e tij?

Kur la mbrapa shtëpitë e fundit të katundit, tamarinasi po sheh një dreq. I thotë, a vjen me mua? Vij, thotë dreqi. Hajde pra, se po të shtij në thes. Në thes nuk mundesh, se jam me shokë të tjerë. Ky thes ju zë të gjithëve, e siguroi rrugëtari. Dhe me të vërtetë i zuri, por u mbush përplot.

Ec e ec, në rrëzën e malit të bjeshkës, tamarinasi pa një njeri që priste dushk. Puna e mbarë të qoftë! E mbara të

gjettë, ia ktheu tjetri. Për ku qenke nisur? Po shkoj me folë me Zotin, se më ka thirrur vetë. Meqë shkon, iu lut druvari, po të jap një zahmet, pyete se ku më ka mua në ata defterët e tij.

Mbasandaj i shkuan sytë te barra e shpinës dhe ia qau hallin:

- Por qenke ngarkuar rëndë, burrë i dheut! Çfarë ke në atë thes?

- Kam do dreqër.

- A po ma fal një mua?

- Meqë kam boll, nuk po ta prish qejfin, - u tregua bujar rrugëtari.

Mirëpo, sapo uli thesin, druvari nuk priti. Ai e zhyti dorën brenda dhe, siç u duk nga rrotullimet e krahut, nisi të shpalonte mbarë e mbrapsht që ta bënte zgjedhjen me të prekur.

- Pse lodhesh kot përt' i përzier?! - foli i habitur tamarinasi.

- Dreq në krye e dreq në fund, të gjithë njëlloj janë!

Mirëpo tjetri nuk po bindej. Çka bëri rrugëtari atëherë? Për të mos humbur kohë, rrugëtari la thesin aty dhe vetë çau përpara.

Mbasi kaloi verën në bjeshkë e ra vapa, zbriti nga stani i mikut. Atje poshtë, rrëzë malit, hasi prapë druvarin. Por tashmë ulur në një cung, duke parë si priste dushk i biri. Edhe pse me shtatin sa një azgan, qysh prej gjymtimit, sëpatën nuk e përdorte. Tamarinasi i piku në zemër dhe e pyeti çfarë i kishte ndodhur. Me dreqërit më ndodhi, tha tjetri. Dhe unë nuk po i përzija mbarë e mbrapsht, siç pandehje ti. Por qysh në fillim, shejtanët ma mbërthyen kyçin dhe dora më mbeti brenda thesit.

Mbasi u largove zotrote, u bëra rixha të ma lëshonin, kurse dreqërit qeshnin e zgërdhieheshin. Tek e vona, dëgjova një zë që foli dreqnisht: “Ne nuk mund ta ndryshojmë tabiatin tonë për hir të askujt. Kur dikush na jep gishtin, ne i marrim dorën dhe kur na jep dorën, ne i marrim krahun. A pranon ti me ta marrë krahun?”

- S’kisha shteg tjetër e pranova. Kur mbeta pa krah, ata dolën nga thesi dhe u shpërndanë, se kishin kryer punë. Pa më trego tashti, çfarë të tha Zoti për mua?

- Nuk tha gjë, se Zotin e gjeta të zënë.

Ai sakati u mjaftua me kaq e nuk zhbiroi më gjatë. Ndërsa tjetri u kthye në Tamarinë. Mirëpo afër shtëpisë i dolën përpara tre burrat, që mbaheshin si më të mençurit e katundit. Dhe menjëherë secili iu drejtua:

- E pyete Zotin se ku më ka mua në ata defterët e tij?

Rrugëtari, që pa dashje shihej si pelegrin, njëlloj deshi të shmangej:

- Përgjigje nuk kam, se Zotin e gjeta të zënë.

Mirëpo burrat s’u kënaqën me këto fjalë. E si mund të ishte Hyji aq i zënë, sa mos të jepte përgjigje kaq të shkurtra?!

- E pse ishte i zënë, - u hoqën kureshtarë, - me çfarë po merrej Zoti?

- Zoti po përshkonte shtëpinë e njerëzimit në vrimën e një gjilpërë, - ua ktheu tjetri, duke u grahur këmbëve.

Po atë mbrëmje, të mençurit u mblodhën sërish. E rrahën sa e rrahën çështjen dhe, më i dituri mes të treve, arriti në këtë përfundim: “Ai topi shenja-shenja, që këtij të lafiturit tonë i është dukur si rruzulli i Tokës, ndoshta s’ka qenë tjetër veçse ndonjë shalqi.”

TETË RRËFIME, sipas JUBËS

Versioni im

Unë kam tjetër version nga ai i Danielit. Zoti Tanashi nuk i vajti në shtëpi dhe as i foli gjithë përunjësi. Sara nuk ka qenë dëshmitare. Takimi u bë në Alma Palma dhe bashkëshortja e Lartmadhërisë mund të ketë pasur ndonjë pësh-pësh nga pronarja e hotelit, mikesha e saj e përditshme. Si nëpunës i bashkisë, e di se zoti Tanashi kishte një ide organizative për ta shpëtuar qytetin dhe pati mirësinë të tërhiqej ca nga kompetencat e tij, duke ia deleguar një personaliteti të Horketës. Por ai nuk vajti te Lumbardi si te Jezusi, sepse nuk priste të gjente Mesinë. Atij i duhej një emisar dhe iu drejtua pikërisht *të fortit*, i cili e kishte bërë lanet karrigen, pa pranuar t'i binte më gjunjë as Kryeministrit.

E kam lexuar më pas Danielin, duke polemizuar në Facebook me mua. Këtij zotërie i dukej e thatë fjala Emisar, ashtu si e tepërt Mesianar. Ai ishte i gatshëm që

ungjin ta quante Misionar. Po unë? Aso kohe mua ende s'më kishte ardhur fjala.

Mbasi ishin ulur në separenë e barit, në çastin kur kryebashkiaku i bëri propozimin, krejt papritur Lumbardi përkuli qafën dhe e mbajti vështrimin në gjoksin e tij. Zoti Tanashi e pyeti i shqetësuar, duke pandehur ndonjë parregullsi të zemrës. Jo, u gjegj emisari, veçse m'u bë sikur dëgjova një si kërcitje dhe, s'di pse, talismani im tani po më duket më i madh. Ndonjë kërcitje mund të ketë pasur, por rritja ishte e pamundur. Pikërisht prej kësaj ngatërrese, Tanashi kuptoi se edhe Aranit Lumbardi ishte prej gjaku e mishi dhe, si gjithë qytetarët e Horketës, mund të ishte prekur nga iluzionet optike. Por ndonëse e çova në skaj, në këtë pikë tërhiqem, zmadhimi i talismanit nuk do të rezultonte aq iluziv.

Tani po kthehem te thelbi. Të pranosh se Tanashi ishte dorëzuar, do të thotë të mohosh të gjitha masat që mori dhe urdhëresat që nxori. Ai i vlerësonte drejt *resurset* (dëshiron të më korrigjojë ndokush?) tona, bletari, manifakturë, blegtori, shërbime. Horketa njihej si qyteti ku mjalti rrjedh si qumështi, thua se ky vendbanim të kishte ekzistuar para bletëve, ose nektari i tyre të ekzistonte vetëm aty. Madje, para shpikjes së antibiotikëve, vetë horketasit kaq e mitizonin këtë nektar, sa besonin se një pikë mjaltë në kërrthizë për njëzet net me radhë mund të shëronte deri në njëzet e shtatë sëmundje. Por kushdo që e provoi për ngrirjen, nuk gjeti shërim.

Për shkak të bletëve, me kalimin e viteve ishte ndryshuar edhe bimësia urbane. Në vend të drurëve

dekorativë, në rrugë dhe në parqe zotëronin pemët frutore. Kur u shtuan aty edhe zgjojet e bletëve dhe ndokush nisi të ankohej, të tjerët i vërsuleshin: “Pse je kundër, zotrote, në Paris ka koshere edhe mbi çatinë e Teatrit të Operës. Pa bletët dhe insektet pjalmuese, njerëzimi do të hante qull gruri e misri.”

Kur malësorët sollën kosheret e para në Horketa, dalëngadalë u përhap një zakon. Kushdo që donte të vinte bletë, për t’i shkuar mbarë, duhej ta niste me një koshere të blerë dhe një të vjedhur. Kësaj nuk i vihej ndonjë shenjë e veçantë, sepse i zoti i ri e njihte nga këndi ku e kishte vendosur. Mirëpo edhe nëse unifikoheshin boja me kosheret e tjera, ndodhte që pa dashje t’i vidhej zgjoi që kishte vjedhur vetë. Në kohën që u shfaq sëmundja e ngrirjes, kaq ishte shtuar vdekja e bletëve dhe kaq humbje po pësonin bletërritësit, sa prej ndonjë paragjykimi kryebashkiaku e ndaloi me urdhëresë të rreptë hajninë e koshereve. Ndërsa me kërkesën e kundërt, atë për të rritur eksportin e mjaltit, fatkeqësisht pësoi fiasko.

Me gjithë mirësjelljen komerciale, që fqinjët kishin dëshmuar më parë, nuk vonoi dhe bilanci i eksport-importit nisi të prishej. Ndërsa hyrja e mallrave të tyre po rritej, kërkesa për mallrat tona ulej. Çfarë ishte kjo perde e njëanshme, ndonjë bllokadë shtrënguese? Unë isha në pozicionin e drejtorit të territorit dhe, kur zoti Tanashi më kërkoi një mendim, i sugjerova që t’i shantazhonte fqinjët, t’u thoshte se do t’u përgjigjeshim me të njëjtën monedhë. Shefi ma ktheu me një buzëqeshje të mezikapshme: “Para se ta kapërdijë qershinë, edhe

zogu e sheh nëse ia nxë suma për ta nxjerrë bërthamën.” E pranoj që tani, Lumbardit nuk do të guxojë t’ia bëjë këtë sugjerim, qoftë nga autoriteti që reflektonte, qoftë se prapanica e tij dinte shumë më tepër.

Katër qytetet kufitare, në ato vise, ishin si Katër Fuqitë e Mëdha për ne. Ndoshta nën ndikimin e Hamivurgut, kësaj superfuqie vendimtare, çdo përpjekje e qeveritarit të Horketës për të takuar shefat e Unionit, pasohej me shtyrje afati. Atëherë, duke synuar krijimin e rezervave jetike, zoti Tanashi u kërkoi tregtarëve që të sillnin sa më shumë mallra. Dhe ata e zbatuan këtë porosi. Por ndoqën edhe instinktin e tyre, shtuan gamën dhe rritën çmimet. Krahas mallrave ushqimore, kinse kundër mërziisë e stresit, u panë në treg gjithfarë lodrash kineze. Nuk munguan as birilat e vogla, papagajtë imitues, revolet me ujë, bastunët magjikë e deri radio-qaforet për qentë.

Pastaj, duke ndier përçmimin e pazëshëm të homologëve unionistë, Tanashi ynë u bë vetë më i zëshëm. Ai dërgoi njëkohësisht katër nota proteste. Mirëpo përgjigjja që erdhi prej andej ishte dërrmuese: “Mjalti i Horketës nuk është vetë Horketa.”

A thua t’i ketë shkuar ndër mend dorëheqja në këtë rast? Për shkak të polemikave që shpërthyen, a thua të ketë dyshuar se zgjedhja e tij në krye të bashkisë kishte ndjellë tersllëk për qytetin? Gjithë ato mëngjese, kur më thërriste për punë, më dukej sikur truri i tij po ngathtësohej, ndërsa në fytyrë i kishte rënë një verdhimë e atillë, thua se natën nuk flinte në shtëpinë e tij, por në Muzeun e Dyllit.

Fërkimi i duarve

Ashtu si për mjaltin, Horketa njihej edhe për dyllin e bletëve. Prej vitesh ishte krijuar Muzeu i Dyllit, logon e të cilit turistët e jashtëm e gjenin në guida si Musée Grevin. Aty shiheshin gjithfarë veprash arti, sidomos basorelieve me peizazhe e natyra të qeta, apo minueta skulpturore mbi kuba e shtylla xhami. Por kishte një pavijon të veçantë me katër shtatore më këmbë dhe dy buste. Asnjëherë shtatë, asnjëherë pesë. Shtatoret ishin të Presidentit të Republikës, kryetarit të Parlamentit, Kryeministrit dhe liderit të Opozitës. Ndërsa dy bustet, të ekspozuara krah më krah më tutje, i përkisnin kryebashkiakut dhe prefektit të qytetit.

Rregullorja për personalitetet që dylloseshin, ishte sanksionuar që në fillim dhe çdo ndryshim ishte po aq i vështirë, sa ndryshimi i Kushtetutës së Republikës. Sipas kodifikimit të saj, asnjë nga personalitetet nuk mund të ishte i përjetshëm në muze, përveçse gjatë periudhës kur ishte në detyrë. Me të ardhur në pushtet pasardhësi, dylli i mëparshëm shkrihej dhe përdorej për shtatoren apo bustin e të riut. Në gjuhën e disa intelektualëve ky proces quhej rimishërim.

Përpara se në muze, kërkimi për tersin nisi në mbarë qytetin, lagje më lagje dhe madje shtëpi më shtëpi. Sepse tersi mund të ishte individ, por mund të ishte edhe një familje. Sapo i vihej gishti dikujt, fillonte edhe mbrojtja: Pse qenkam unë tersi?! Vetëm pse jam njeri leshator dhe, për të zezën time, sa më shpesh e depiloj, aq më shpejt më rritet?!.. Pse qenka tersi familja jonë?

Apo pse burrë e grua jemi çalamanë, ndërsa djaln e kemi handikapat. Zotërinj të tersit, mos i mbani sytë vetëm poshtë, hidheni vështrimin edhe lart!

Dhe ata që ishin lart, formalisht më lart se të gjithë, ndodheshin në muze. Po kujt t'i vihej gishti aty? Tersit nuk mund të përcaktohej qesim. Për t'u treguar politikisht të paanshëm, u vendos që të hidhej short me katër gogla. Sipas shortit tersi doli lideri i Opozitës. Po çfarë të bënin tani me shtatoren e tij, si ta hiqnin nga muzeu pa prova të tjera dhe ku ta çonin? T'ia përcillnin në Tiranë me një dërgatë si dhuratë? Ky do të ishte një hap fatal, sepse do të nënkuptonte se qytetarët e Horketës ishin për sistemin monist, ata nuk e donin ekzistencën e opozitës. Meqë goglat nuk qenë paraparë në rregullore, bordi i muzeut nuk ishte i detyruar ta zbatonte shortin e parë. Prandaj u kalua te shorti i dytë, ai i busteve.

Mirëpo, mu aty përpara bordit dhe në pritje të shortit, dy pushtetarët e Horketës u treguan altruistë të vërtetë. Njëri prej tyre pranoi vullnetarisht që të hiqej busti i tij. Ky ishte prefekti. Ai bëri një deklaratë të singertë, duke pranuar epërsinë e pesë të tjerëve, të cilët ishin të zgjedhur nga populli, kurse ai ishte i emëruar. Pastaj shfaq një dëshirë, që nuk hasi kundërshtime. Ai e çoi bustin në fabrikën e qirinjve dhe, teksa fërkonte duart, ofshani me një zë të dëlirë: “Shpirti im u bëftë dritë!”

Megjithëse drurët po i hapnin sythet, temperaturat nuk po rriteshin. Mos do të kthehej i ftohti? Ky parashikim e bënte më kërcënuese sëmundjen e paralizës. Nga frika mos ngrinin e mbeteshin sakatë, kudo shiheshin njerëz që fërkonin duart. Në sytë e secilit fërkimi i shuplakave

merrte kuptime të ndryshme. Për disa: “Mjerë ne, nuk dimë si do t’ia bëjmë hallit që na ka zënë!” Për të tjerë gjesti jepte kuptimin e një çlirimi: “Oho-hoo, unë i lava duart nga rreziku!”

Horketasit shpresonin se, duke i nxehur duart me fërkim, do t’u ngrohej edhe gjaku, çka i mbronte nga ngrirja. Mirëpo kjo lajthitje, që e përhap shpejtësia dixhitale, do ta detyronte BiBo TV-në të ftonte me ngut një specialist të hematologjisë. Duke shpjeguar koagulimin, ai përmendi me radhë përbërësit e gjakut, bashkë me përqindjen e secilit. Sasia e ujit, çka edhe më parë kishte qenë e ditur, kësaj here pati një efekt të veçantë te teleshikuesit. Kaq i hyri tuta Dafinës së Isuf Matrallozit, sa pas emisionit i tha të shoqit: “Mister i madh është trupi i njeriut, toger! Tash e tutje do ta racionojmë ujin në shtëpinë tonë. Uf, Isuf!”

Kushdo që pohonte se paraliza e pjesshme krijonte figura nga më të çuditshmet, si dramatike e si komike, ka thënë një të vërtetë. Për shembull, ç’mund të bënte kalimtari që ia zinte sëmundja vetëm njërën këmbë, nëse nuk kishte mbështetje në çast? (E ka përmendur Danieli këtë rast?) Ai ose ulej aty ku ndodhej, ose do të kërcente me këmbën tjetër, derisa të gjente një zgjidhje të përshtatshme. Zakonisht i mbetej versioni i kërcimit, sepse ndonëse shihej në ç’pozicion kishte ngrirë, nga frika e infektimit të tjerët ngurronin për t’iu qasur. Horketasit vetëm e këshillonin në distancë, kthehu majtas, shko nga e djathta, ke andej një shtyllë për t’u mbajtur, ke këtej një bordurë për t’u ulur. Po sikur, i zënë ngushtë, i sëmuri të ulej në pragun e butikut më të

afërt? Çfarë bënte ahëre pronari i shitores, si sillej ai? E dëbonte, e ngushëllonte, e qeraste me ndonjë kafe, tmerrohej nga ideja se qysh prej atij çasti askush nuk do t'i shkelte më në dyqanin e molepsur?!

Komiteti i Shpëtimit të Qytetit, i udhëhequr nga Aranit Pjetër Lumbardi, dyqane të tilla do t'i damkoste më pas, duke u ngjitur në xhama shiritin paralajmërues për blerësit: “Ju e dini si po hyni, por nuk e dini si mund të dilni nga kjo derë!” Në raste të tilla, afërmendsh, Karapicit i kujtohej ajo shpallja tjetër: “Qeni që blihet nuk kthehet.” Veçse tashmë ai e kishte gjetur përgjigjen: “Përderisa Tanashi, njëshi i Horketës, nuk e jep dorëheqjen për hir të mbajtjes së pushtetit, përse u dashka që, për hir të një shitësi mosmirënjohës, unë t'u jap lamtumirën qenve të racës?!”

Sikur do të më rrihte

Megjithatë, dorëheqje pati. Jo një, por dy. Madje imja është e para. Më pas, deri në njëfarë mase, e pranoj se e tradhtova Misionarin. Ndërsa kalimin nga Jubë në Judë do të ma bënte tjetërkush. Prej një të huaji më erdhi damka. Dhe kjo më vret më tepër.

Kur pati fituar zgjedhjet Lumbardi dhe hyri në bashki me tërë atë mbështetje, mua më gjeti gjithnjë në detyrën e Drejtorit të Zyrës së Territorit. Të gjithëve ne që kishim pozicione drejtuese, na shkoi mendja se për të krijuar oborrin e vet, Mbreti i ri do të na zëvendësonte me oborrtarë që gëzonin besimin e tij. Prandaj qysh ditët

e para i paraqita dorëheqjen. Në fund, duke ia njohur aftësitë administrative, i sugjerova që në detyrën time të merrte të ashtuquajturin *Dyfishi*. Pastaj nënshkrova: Me respekt, Jaho Juba.

Lumbardi më thirri në zyrë pas një jave. Ishim kundërshtarë politikë dhe kisha bindjen se do të më lironte pa e zgjatur. Kishte mbi tryezë dorëheqjen time dhe, kur foli, ende i mbante sytë në tekst, sikur po e lexonte për herë të parë.

- Jam kureshtar ta di, - tha, - e kujt është nofka *Dyfishi*?

- Imja, - buzëqesha. - E sajova nga dyfishimi i J-së, **Jaho dhe Juba**.

Ai ngriti kokën, por unë nuk e fika buzëqeshjen. Edhe teksa e shkruaja atë sugjerim, kisha buzëqeshur vetmevete. Nuk e dija tamam përse mendja më ndillte zi, por zemra rezistonte.

- Grise, - tha Lumbardi për dorëheqjen, duke ma tundur atë copë letër para fytyrës, sikur do të më rrihte me të. - Unë e kam zakon të eci me dy trimëri dhe një dredhi. Ti paske të kundërtën, dyfish hile e një trimëri. A mundet që drejtori ta shohë veten edhe si këshilltar i kryebashkiakut?

Pranova menjëherë, por modestisht. Vetëm pasi i pimë kafet, pra pasi ia kishte vënë kapakun vendimit, rashë në gropë me këmbët e mia. Po në cilën? Në gropën që hapa vetë. Për t'i dhënë provën e parë të besnikërisë, e këshillova që kabineti i tij të kontrollohej me Detektor EMF, për të zbuluar nëse kishte aty ndonjë kamera të fshehtë apo mjete të tjera pa tela. Por të hetohet edhe makina juaj, zoti Lumbardi, shtova. Sepse kur flisni

në makinë, xhami krijon dridhje, një sistem me infra të kuqe mund t'i shndërrojë ato dridhje në fjalë dhe, kështu, ju përgjoheni.

Ndoshta mendonte njëlloj si unë. Gjithandej jetohej përballë një realiteti të sofistikuar, përgjimet, filmimet e fshehta, thyerjet e fjalëkalimeve, kërcënimet e shantazhet dixhitale, deri edhe përhapjet e video-seksit intim, po bënë namin në Horketa. Madje, as çehra e fytyrës nuk i ndërroi. Veçse më hodhi një vështrim të flashkët, nga ato që i ngjajnë ujit të ndenjtur, si të kishte takuar para meje mijëra Juda si unë dhe t'i qenë lodhur sytë. I mësuar që t'i drejtoheshin me mbiemrin e tij të gjatë, mua m'u drejtua duke bërë një bashkim rrokjesh të emrit e mbiemrit, thua se isha ndonjë adresë e-mail-i.

- Mund të kthehesh në zyrë, Jajuba.

Aty për aty pata një ndjesi distance, e cila as më mbrapa nuk m'u shqit. Por prapëseprapë ishte ende larg dita, kur nga Jajuba do të më dukej sikur thuhej: Ja, Juda!

Premtimi

Si u mbyll ai vit dhe nisi i dyti, na u tha se Kryeministri do të vinte për vizitë në Horketa. Nuk u habitëm. Madje na u duk pakëz e vonuar, pasi ishte e njohur miqësia e tyre e ngushtë. Thuhej se në bisedat telefonike ende e kujtonin ekipin e volejbollit Studenti Bulls, ngjyrat e të cilit i kishin mbrojtur së bashku, Lumbardi pasues dhe lideri i ardhshëm zhytës. Një javë para se ta shpallte

datën e vizitës, stema e bashkisë u pastrua me kimikate. Ndërsa shtiza e flamurit u këmbye, asaj prej druri ia zuri vendin një shtizë e kromuar. Përveç mobilizimit të administratës, edhe Danieli iu gjet në krah ungjit të tij, sidomos për dekorin e sheshit dhe të tribunës së mitingut.

Mbasi e priti në shkallët e portikut, Lumbardi e ftoi Kryeministrin në kabinet. Aty u mbajtën edhe bisedimet në një rreth që, për të qenë i saktë, m'u duk më i ngushtë sesa e kisha përfytyruar. Kishte qenë i qëllimshëm nga shefi ynë, në mënyrë që komunikimit zyrtar të mos i mungonte as atmosfera intime. Lumbardi nuk e shpërqendroi vëmendjen në gjithfarë ankesash të vogla, as në shtimin e një ure, siç u përfol më vonë. Ai shtroi një kërkesë të vetme, të cilën e quajti strategjike. Nuk ishte se e dëgjoja për herë të parë, horketasit e ëndërronin prej vitesh rritjen e frymëmarrjes së qytetit.

- E cila qenka kjo frymëmarrje? - pyeti Kryeministri.

- Një dalje në det përmes Hamivurgut, - tha Lumbardi.

- Po ju nuk keni ndonjë flotë detare, - buzëqeshi mysafiri me të njëjtin hutim. - Pastaj lidhja me Hamivurgun nuk mungon, një vrap pele bëhet me makinë.

- Duam hekurudhë, zoti Kryeministër, - ngulmoi tjetri.

- Hekurudhë?!

- Dhe meqë përmendët flotën, miku im, - e ndryshoi gjuhën Lumbardi, - treni është flota tokësore e botës.

Kryeministri prapë buzëqeshi. Veçse si ta shihte vëllbollistin në anën tjetër të vijës, prej ku i kishte ardhur një top i lartë mu pranë rrjetës, ia ktheu kundërshtarit menjëherë me një goditje sa të fortë, aq edhe logjike.

- Aranit, nuk e ke llogaritur mirë. Çfarë ke parasysh ti, kavanoza e pite mjalti, qirinj e mushama dylli? Apo shegë dhe veshje për kukulla? Këto do të transportoni ju?!.. S'ka ç'i duhet Horketës hekurudha. Sa për udhëtarët, trenat tanë ecin këmbadoras, në këtë gjendje e kemi shërbimin hekurudhor.

Megjithatë, Lumbardi nuk u dorëzua. Në mbështetje të tij folën edhe të tjerë, sidomos senatori Nini Tomçini, më i flakti i këshillit. Ata sollën argumente nga më të ndryshmet, deri edhe pagesën nga fondet e bashkisë për studimin e fizibilitetit dhe platformën e stacionit. Kur më erdhi radha mua, m'u desh t'i mbaja sytë herë nga njëri e herë nga tjetri. Por, afërmendsh, shefit tim nuk iu drejtova as me Lartmadhëria Juaj, as Kryebashkiaku ynë, për ta ruajtur *kreun* e krerëve për Kryeministrin. Me gjasë, Lumbardi nuk e vuri re këtë yçkël. Madje, për të krijuar ca humor, i rrëfeu mysafirrit historinë e dorëheqjes sime me dyfish dredhi e një trimëri. Duke ia njohur tipin mikut të vet, s'e di çfarë i shkoi nëpër mend Kryeministrin. Por ndodhi çfarë në ato çaste nuk pritej, ai u thye disi, duke na u drejtuar të gjithëve.

- Si thoni ju, nuk është e lehtë të refuzohet me këmbët e para kërkesa e një Mbreti, apo jo?! Mirë pra, meqë është një degëzim hekurudhor ndërqytetës, mbetet për t'u parë mundësia. Mundësia thashë, këtë e theksoj.

Fjalët e fundit i tha si duke i murmuritur. Pastaj edhe psherëtiu. Në fakt, për aq sa u bisedua më pas në zyrë, ky premtim i dhënë përgjysmë s'u zu më ngoje, thua se duhej mbajtur patjetër i fshehtë, midis nesh dhe vetëm midis nesh. Ndërkaq, Lumbardi më thirri veças

dhe më dha dy porosi, paradhoma të sillte kafet dhe t'i siguroja katër metër litar, të cilin ta kisha të gatshëm në tribunë.

Unë nisa me urgjencë në shitore, por hasa bashkëshorten e Lumbardit që po dilte prej një butiku, me një çantë ambalazhi. Kushedi çfarë firmatosh kishte blerë. Ledi Sara (i pëlqente ta thërrisnin kështu, siç nuk i bënte buzë as nofkës Saraçineska) kishte mënyrën e saj kur ulej me shoqe nëpër restorante, ose kur hynte në butikë. Nëse i pëlqente një rrobë, nuk pyeste sa kushtonte. Ajo e merrte plaçkën dhe linte aq të holla, sa ç'ia vinte çmimin vetë. Shpesh, prapëseprapë, pronarët nuk donin t'i merrnin asnjë kacidhe zonjës së qeveritarit, duke i konsideruar plaçkat dhuratë. Por në raste të tilla Ledi thoshte: “Mos ngulni këmbë, nuk komprometohem. Dhurata verbon atë që sheh dhe prapëson fjalën e njeriut të drejtë.”

Para martesës ajo bëri dy biseda të shkurtra. Në fillim me vjehrrin, të cilin e pyeti se nga kishte rrjedhur mbiemri i tyre. Pjetri nuk e dinte se kur ishte bërë kalimi nga Lumbardhi në Lumbardi. Megjithatë, një gjë e thoshte me siguri, Lumë të Bardhë tashmë nuk ka, ujërat janë ndotur në tërë botën. Mbas kësaj, nusja e ardhshme njoftoi Aranitin: “Fëmijët me ligj marrin mbiemrin e të atit. A nuk jam dhe unë fëmija i babait tim? Prandaj do të mbajë mbiemrin e tij.” Thuhej se Sara Çesku kishte shumë pushtet tek i shoqi. Kujtdo që kishte ndonjë hall për të zgjidhur dhe s'po arrinte ta zgjidhte, i këshillohej krahëmarrja. Kjo do të thoshte të siguronte përkrahjen e Ledit: “Po hyri në lojë Sara Çesku, të hapet saraçineska në bashki.” Këtej dhe nofka e saj.

Ndonëse më vlonte koka, nuk mund të kaloja pa e përshëndetur dhe, ashtu në tym, e pyeta si ishte me shëndet Pjetri. Pa hyrë në hollësira për cilin Pjetër pyesja, si zakonisht, ajo i përfshiu të dy: “Mirë janë edhe Pjetri që lashë në gjini, edhe tjetri që kam në shtëpi.” Vjehrrin e përfshinte për statusin familjar, sepse shtëpitë i kishin veç e veç. Kryebashkiaku banonte në tortën urbane të qytetit, ndërsa i ati s’e lëshonte “kullën” prej guri në Lagjen e Malësorëve.

Litari

Teksa nxitoja drejt shitores me materiale ndërtimi, vetvetiu pëshpërita: “Zot i madh, m’i ruaj mendtë e kresë, po litari ç’i duhet atij?! Mos i ka hipur damari ta lidhë Kryeministrin dhe ta mbajë peng, derisa të jetë ngritur traseja, të jenë shtruar shinat dhe të ketë kaluar treni i parë në hekurudhën e re?!” E kisha dëgjuar njëherë t’i thoshte dikujt, kafshatën mund ta fusësh ndër dhëmbë, por pa kapërcyer lugun e fytit, ende nuk je i sigurt se është e jotja, pasi ndodh që ta nxjerrin edhe nga goja.

Në tribunë i takonte Lumbardit të hapte mitingun, para se t’ia jepte fjalën mysafirrit. Dhe ai e hapi me një sihariq, duke e shpallur fakt të kryer premtimin e Kryeministrit për hekurudhën, çka u prit me brohoritje nga publiku që kishte mbushur sheshin para bashkisë. Shì atë çast u kthye nga unë dhe më dha shenjë për litarin. Natyrisht, unë e kisha përmbushur porosinë. Por pa ditur qëllimin përse do ta përdorte, kisha bërë zgjedhjen time:

katër metra nga litari më i hollë. Dhe për çdo rast, diku nga mesi, i kisha bërë një vizatje me bisturi.

Lumbardi ynë ia dha njërën cep mysafirit, pastaj vetë u zmbraps, duke e shpëstjellë rrotullën deri në cepin tjetër.

-Tani tërhiqe, - i foli në emër, - mos e lër litarin të lëshojë bark. Tërhiqe ti, që ta tërheq edhe unë.

U qetësova menjëherë. Prej miqësisë së tyre të hershme, e mora si një shaka sportive, për të ngjallur humor të përgjithshëm. Mirëpo me tërheqjen e parë litari u këput në pikën më të dobët. E ndjeva si më përvëluan sytë e Lumbardit. (Mos më ka sharë me roc e koc?!) Më hodhi një vështrim plot çakërdisje të thellë, çka ia egërsoi njëkohësisht edhe pamjen. Ai njeri kërkonte gjithnjë rezultatin dhe, kur s'i pëlqente puna e ndonjë nëpunësi, i ndryshonte dukshëm zëri teksa shfrynte: "Fajin e kam vetë që u besoj batallave dhe hardallave!" E pranoj, Lumbardi ishte dixhej i vetvetes. Kur fliste, i zotëronte tërë siguri modelimet e tonit, aq sa prej rrëmbesës si e thoshte, të tjerët harronin çfarë po thoshte. Por nuk e bënte me vetëdije. Ishin emocionet komandat e zërit. Horketasit ia njihnin fermentin e fortë, madje edhe në rrethe kafenesh thuhej nganjëherë: "Ky Lumbardi ynë është si fitili me barutin përbrenda. Veçse po i hyri flaka, merr zjarr njëkohësisht nga të dyja anët."

Me një tip të tillë s'kisha si të mos gabohesha për atë lojën sportive. Qëllimi tij kishte qenë tjetër, donte ta rrihte hekurin sa ishte i nxehtë, duke ia shkullur Kryeministrit premtimin nën dëshminë e horketasve. Pasi bashkoi këputjen me një nyje të fortë, sapo filli

u tendos mes tyre, nga një nocion abstrakt e bëri të prekshme besën për hekurudhën me tri trimëri, një dredhi dhe katër metra litar. Nga e kishte këtë të litarit? Unë, këshilltari i tij, nuk ia kisha këshilluar, sepse as që e dija ndopak. Por ndoshta e kishte nga Pjetri, i ati.

- Populli i Horketës e di se, kur jep besën, besa të lidh, - thirri Lumbardi.

-Të lidh, të lidh, - iu gjegjën me brohorima qytetarët, duke e vënë Kryeministrin me shpatulla pas murit, sikur ai premtime të ishte tashmë çështje e mbyllur.

Në të vërtetë, sapo kaloi koha që Kryeministrit iu desh të konsultohet me stafin e tij, u mbyll për të kundërtën. Para se ta merrte troç mohimin për hekurudhën, Lumbardi diç kishte nuhatur, sepse një ditë më pyeti në korridor:

- Mos ma fshih tani, si ndodhi që litari doli i dobët atëherë, ndërsa ti u stepe nga frika? Ta kishte hedhur bakalli, apo pate ndonjë parandjenjë të keqe?

Mua më mjaftoi që nuk shfaqti dyshime për bisturinë time dhe, më tepër se me fjalë, ia ktheva duke ngritur supet. Ndërsa të nesërmen hartoi letrën e dorëheqjes. Sipas Çica Laçit, sekretares në paradhomë, letra përfundonte me fjalët: “Një litar që nuk rri i tendosur, por më bëhet lak ndër këmbë, unë e këpus me dhëmbë.”

Me t’u marrë vesh, në qytet u tha se Mbreti abdikoi nga fronin.

Komiteti i Shpëtimit

Kryetarit të ri të bashkisë i ra shorti të përballej me të përbindshmen, paralizën që ngërtheu Horketën. Ndonëse pa përvojë të gjatë administrative, zoti Tanashi prapëseprapë nuk i ngriti duart përpyetë. Njëra nga masat që ndërmori për t'i mbajtur në formë qytetarët, ishte urdhëresa për fizkulturën e detyrueshme. Çdo ditë, në orën dhjetë të paradites, binin sirenat. Nëpunësit dilnin nga zyrat, shkollarët nga klasat, të sëmuret rreshtoheshin në korridoret e spitalit. Qarkullimi ndërpritej, njerëzit zbrisnin nga makinat dhe, për shtatëmbëdhjetë minuta, bënin ushtrime fizike aty ku ndodheshin. Mbi tarracën e prefekturës shihej prefekti, shefi i policisë dhe kryeprokurori së bashku. Kryebashkiaku ushtrohej prapa ndërtesës së bashkisë me drejtorin e shëndetit publik dhe trajnerin e ekipit të futbollit, të cilit tani i duhej që të gjitha ndeshjet pritëse t'i bënte në fushë asnjënjë.

Sigurisht, ishte diskutuar për specifikat e grave shtatzëna, fëmijët e moshës miturake apo qytetarët e moshës së tretë. Por debate të zjarra kishte pasur për orarin fiks (Pse në orën dhjetë?!) dhe sidomos kohëzgjatjen e fizkulturës. Si argumentohej përcaktimi shtatëmbëdhjetë minuta dhe jo rrumbullak pesëmbëdhjetë ose njëzet?!

Por në vend të jepej pas llafologjisë, duke synuar forcimin e administratës, Mentor Tanashi u mor me emërimet e çëmërimet zyrtarësh. Veçse duke dashur të mbyllte veshët, iu shmang opinionit të qytetarëve dhe nuk i ndjeu gabimet që po bënte. Derisa një ditë, në party-n e fundit që shtroi Ledi Sara, gruaja e ish-

kryebashkiakut ia citoi si rastësisht gruas së Tanashit këtë ankim të Glosterit: “S’ë di. Po bota u bë kaq e keqe, sa zoçkat hanë ku s’guxojnë shqipet. Që kur çdo horr u bë këtu fisnik, shumë fisnikë janë bërë horra. Ofiq e zyra ndahen për fisnikë, të cilëve deri dje s’u dihej fara.”

Kështu shpjegohet që, kur u bë takimi në Alma Palma, njeriu i pushtetshëm kishte qëmtuar me vetëdije çfarë i dukej më e përshtatshme nga “Rikardi III” dhe vajti i përgatitur tek Emisari që dëshironte, por që s’mbante më asnjë pushtet zyrtar. Këtij fakti i shtohet edhe përfytyrimi unitar që kishte dëshmuar Lumbardi për komunitetin dhe përkrahja nga shumica e Horketës. Ndryshe nuk shpjegohet përunjësia që u vërejt prej palëve, kinse po luanin teatër me njëri-tjetrin.

Tanashi: Pranoni imzot, ju luten qytetarët. Mos e shkelmoni dashurinë e tyre.

Lumbardi: S’ë kam prej guri zemrën dhe lutja juaj po më bën të bindem.

Tanashi: A doni të kurorëzoheni nesër?

Lumbardi: Si të vendosni, kur të dëshironi.

Dëshira ishte e madhe. Prandaj, me vendim të këshillit senatorial, Aranit Pjetër Lumbardi u kurorëzua President i Komitetit të Mobilizimit dhe Shpëtimit në situatën më të rëndë të Horketës. Dhe ndërsa emri i komitetit do të ndryshonte disa herë, ai vazhdoi të qëndronte në krye të tij, derisa i hodhën prangat.

Tryeza e rrumbullakët

Në mbledhjen konsakruese pati një surprizë të shpëlarë, sepse ishte imitim i një imitimi. I ri dhe befasues qe veç ofiqi tingëllues. Kur të gjithë ne, anëtarët e Komitetit, kishim zënë vend për qark tryezës së rrumbullakët, në çastin që Lumbardi do të hynte në sallë, u dëgjua një zë: “Hapeni rrugën, po vjen Shkëlqesia e tij Presidenti!” Ne vetvetiu u ngritëm më këmbë, kurse atij iu terratis vështrimi dhe bëri një gjest nervozizmi, duke e çuar njërën dorë përtej supit, si për të na thënë: “Ju, që jeni bërë pjesëtarë të këtij stafi dhe që një ditë mund të më bëni horr, hidhni pas shpine çdo shpresë për humor!”

Dhe ndoshta kishte të drejtë, më pas ne harruam çfarë ishte buzëqeshja.

I lejuar bujarisht nga zoti Tanashi për të marrë gjithçka dëshironte nga inventari fizik i kabinetit të mëparshëm, Lumbardi kishte pëlqyer vetëm karrigen prej drulisi, atë me ndenjësë të gjerë, këmbë të rënda, shpinore të rehatshme dhe mbështetëse anësore për krahët. Ndonëse me ndihmën e Danielit në atë model e kishte porositur vetë, ai fron i bollshëm sikur ia zvogëlonte edhe më përmasat e trupit të imët. Gjithsesi, me t’u ulur, shpalli rendin e mbledhjes, që e kishte hartuar për gjithë natën. Nga pamja që i kishte marrë fytyra e zeshkët dhe nga sytë e thatë prej asketi, ai dukej sikur as që kishte hyrë ndopak në dhomën e gjumit, por me mendje ishte qysh të mbrëmshmen në këtë sallë.

Sipas Lumbardit, emërtimi i Komitetit tingëllonte disi i përgjithshëm, aq më tepër që nuk shprehte njërin prej

thelbeve të punës së tij. Cilin? Identifikimin e sëmundjes dhe të sëmurëve, sidomos të sëmurit të parë, prej të cilit mund të kishte ardhur molepsja. Dhe ne prej këtej do ta fillonim shqyrtimin, por më parë duheshin zgjedhur komisionerët.

Mbasi u zgjodh Komisioneri i Inspektimit dhe Identifikimit, Komisioneri i Shpërnguljeve të Detyrueshme dhe ai i Kufirit, i erdhi radha Komisionerit të Marrëdhënieve me Jashtë. Në këtë komision e gjeta veten, çka më befasoi me të vërtetë. Ai deklaroi se në këtë betejë do të kishte nevojë për gjashtë cilësi dhe, kur e përsëriti shprehjen, e axhustoi me tri trimëri e tri diplomaci. Kuptova se, duke llogaritur cilësitë e përbashkëta, marrëdhëniet me jashtë do t'i udhëhiqte vetë, ndërsa mua më kishte zgjedhur si diplomat ndihmës, njëfarë këshilltari i tij.

Në përbërjen e Komitetit, krahas nëpunësve nga administrata, Lumbardi kishte përfshirë më tepër specialistë nga shoqëria civile, madje edhe tre anëtarë nderi pa të drejtë vote, njëri syresh Danieli. Në të djathtën time ishte ulur Vilson Karapici që, herë pas here, më hidhte shikime plot dalldisje krenare. Ndoshta pandehte se i qe bërë ai nder, ngaqë propagandonte se kishte kujtime të paralindura, siç ma kishte zënë veshi, po aq sa Pjetri. Në mos babai i Lumbardit, po them ai tjetri. Mirëpo unë e dija, aty ishte thirrur si specialist i mjekësisë. Jo më kot u caktua zëvendës i ndihmësit të parë të Komisionerit të Shëndetit Publik.

Me kaq mbaroi seanca e paradites, për t'u rikthyer mbasdite në 17:30.

Seanca e dytë

Ne u shpërndamë nëpër qytet për të mbledhur informata se cili kishte qenë mbartësi i parë i sëmundjes, sepse pavarësisht ndarjes sektoriale, në raste aksioni na kërkohet të punonim jo vetëm një për të gjithë, por edhe të gjithë për një. Kjo ndërthurje e vështirësoi disi seancën e dytë, ngaqë komitetat kundërshtonin njëri-tjetrin, derisa u pranuan dy versionet më të mundshme. U tha se njeriu i parë që e kllaposi sëmundja, nuk ishte klouni i cirkut, por ose biznesmeni Muçi Muçollari, ose balerina Renata Bollano.

Në fillim u dëgjua rasti Muçollari.

Raportuesi tregoi se biznesmenin e kishte zënë sëmundja, teksa dilte nga Tenisklub. Ai po shkonte në bankë për një veprim financiar, kur ndjeu një akullim që i zbriti rrufeshëm nga koka deri te shputat e këmbëve. Ishte si një goditje korrenti që më paralizoi menjëherë, do të thoshte Muçollari. Sapo ngriu në vend, u mblodhën rreth tij gjithë sa ishin pranë. Madje, për ta lehtësuar apo kushedi përse, dikush synoi t'ia hiqte nga dora edhe çantën kuletë, por të tjerët nuk e lanë. Megjithëse çudia ishte e madhe, nuk zgjati shumë. Një miku i tij, i cili për nuhatjen që dëshmonte në biznes e pati cilësuar “qeni eracak i parasë”, nxori nga portofoli një kartëmonedhë 500 eurosh dhe ia vuri Muçollarit nën hundë. Mirëpo marifeti nuk dha rezultatin e pritshëm. Atëherë shkrirjes i doli për zot farmacisti, që u afrua me një shishe amoniaku të lëngshëm. Si e lagu tamponin mirë e mirë, po aty ia vuri edhe ai, nën

hundë. U duk se Muçollarit i luajtën qepallat. Veçse në atë çast dikush kishte nisur t'i thërriste thekshëm në emër: "Muçi, Muçi im!" Prej alarmimit disa pandehën se e shoqja e kishte marrë vesh fatkeqësinë dhe ishte kthyer e tmerruar nga rruga, që të çonte në *Friend's Book House*. Jo, ishte e dashura.

A kishte në këtë shkrirje një bashkëveprim të tri efekteve? Kjo dilemë ndezi kundërthënie. Duke dashur t'i merrte të gjitha meritat për vete, farmacisti bëri një përmbledhje: "Dëgjoni, o mosmirënjohës! Një njeri, sado t'i ketë xhepi dhe sado të bëjë dashuri, mund ta humbë vetëdijen edhe nga një dhimbje barku. Por atë patjetër do ta sjellë në vete amoniaku!"

- Dhe, ja, tani argumenti pse Muçollari ka qenë i sëmuri i parë, - e përforcoi ndjeshëm zërin raportuesi. - Ndaj tij nuk u përdorën as shkulpja e veshit, as shuplakat turinjeve, as tymi i leckës së djegur dhe as revolja në lule të ballit. Këto marifete u shpikën më mbrapa.

- E kur paska ndodhur ngjarja, ç'ditë ishte? - pyeti Komisionerja e Afateve, detyra e së cilës ishte që, me t'u marrë një vendim, të mbante nën kontroll kohën e zbatimit.

- Ngrirja ndodhi për të hënë, një ditë plot qarkullim, - u gjegj tjetri, pa nuhatur ende qëllimin e pyetjes.

- Ahere po ju kap mat, - ia priti Alma Nepravishta duke lëvizur dorën, si të kishte përpara ndonjë fushë shahu.

Me atë lëvizje Komisionerja e Afateve hodhi mbi tryezë një fletëpalosje, që i përkiste baletit "Zogjtë e Parajsës". Shfaqja ishte dhënë në Qendrën Kulturore tri net rresht, nga e premtja në të diel, siç e tregonin edhe datat e ngjyrosura me lapsutël. Me këtë fakt

të pakundërshtueshëm, ajo fitoi përparësinë e kohës se nuk kishte qenë Muçollari, por Renata Bollano simptomatikja e parë e sëmundjes.

- Fjala për ju, zonjë, - i ndaloj pyetjet e tjera Lumbardi.

U kuptua se po i hapte udhën raportimit të ri, atij të Nepravishtës.

Renata dhe Sara

Mjeshtri i baletit Edor Egro, që ishte edhe vetë balerin, kishte qenë duke bërë prova me partneren Renata Bollano, kur ndodhi një panatyrshmëri. Për pak sekonda, ndërsa e gjithë trupa kryente figurën e radhës, ajo mbeti e shtangur. Edori u habit. Por meqë pas një grime balerina lëvizi, e la të vazhdonte. Pas provave, ca nga merakut e ca nga kureshtja, e pyeti se ç'ishte ajo ngecje, ndonjë shpërqendrim i vëmendjes apo harresë e figurës. As unë nuk e di si ndodhi, u gjegj tjetra, një mpirje e papritur m'i ngriu muskujt e krahëve.

Mjeshtrit i mbeti xanxë. Një natë para premierës ishte ende aq i lëkundur, sa mendoi ta zëvendësonte partneren me dublantën e saj. Mirëpo kur ia shfaqti këto dyshime, Renata Bollano buzëqeshi, veçse duke e siguruar për të kundërtën. Në të vërtetë, gjatë shfaqjes premierë do të dilte intuita e mjeshtrit. Dhe pikërisht në duetin më dinamik, siç e kishte paraparë rrezikun Edori.

Në skenën finale, kur apoteoza e dysheve së dashuruar mbërrinte kulmin, teksa çiftet e tjera po i vinin rrotull skenës për të krijuar shtjella (simbolikë e gjendjes shpirtërore të protagonistëve), Renatës iu përsërit

ngecja. Sipas figurës së libretit, ishte ajo që nisej drejt partnerit, duke valëvitur krahët e duke bërë tri pirueta. Por meqë dama s'po lëvizte dhe Edorin e përfshiu frika e mëparshme, kavalieri u nis vetë drejt saj. Ai ia vuri duart nën sqetulla dhe, ndërsa ia hapte krahët me takt duke u dhënë mbështetje në bërrylat e tij, e shkëputi pakëz nga tabani. Pastaj bëri një rrotullim në vend dhe katër të tjera drejt kuintës anësore, me synimin për të dalë nga skena. Por bash atëherë ndjeu se si krahët e saj po fërgëllonin mbi bërrylat e tij, madje e dëgjoi balerinën që i foli:

“Më lësho, më lësho! Jam shkrirë, jam shkrirë! Dancojmë, dancojmë!”

Natyrisht, zëri i saj s'u dëgjua nga shikuesit. As ngecja, që kësaj here kishte qenë më e shkurtër, nuk u kap. Por ndodhej në sallë një ish-kampione e asaj skene, e cila vetëm disa vite më parë kishte interpretuar si protagoniste edhe te “Zogjtë e Parajsës”, edhe te “Fluturimi i fluturave”. Sara Çesku e kapi ngecjen. Pastaj mësoi edhe fjalët që Renata Bollano i kishte thënë Edorit. I mësoi nga berberi i dikurshëm Florian Çesku, i cili në fillim kishte rruar mjekrat e burrave horketas, pastaj kishte përparuar me kurse duke u bërë i gjithanshëm, parukier, grimier, elektrikist dhe fonist i Qendrës Kulturore. Sara s'e dinte atëherë se pikërisht prej kushëririt të saj do të tradhtojë edhe vetë një ditë.

Ndoshta me të drejtë, Ledi e shihte veten si person publik. Jo aq nga i shoqi, sesa për arsye speciale. Sara donte që vazhdimisht të ishte *in*. Shumëkush mendonte se e kishte mani, madje e tepronte kur ngulmonte se një person publik e ka për detyrë të jetë *in*. Pa le kur i

thuhej se me modelet e saj stilohej prej kohësh gjysma e qytetit. E pse jo, ia priste Sara, tekefundit njerëzit shohin tek unë gjithnjë diçka ndryshe, ndoshta atë që vetë nuk guxojnë ta bëjnë.

Diçka e tillë ishte e dukshme edhe natën e premierës. Vërtet, lyerjen e flokëve ngjyra-ngjyra, atë unicorn dhe atë me pigmente fosforeshente, ajo e kishte sjellë e para në Horketa. Por pasi ishte bërë trendi në qytet, si mund të shkonte vetë zonja aq e uniformuar në një spektakël baleti?! Dhe për më tepër te “Zogjtë e Parajsës”. Kur zoçka ekzotike ishte në skenë, dukeshë qesharake po të shiheshë në sallë me të njëjtin stilim.

Atë mbrëmje qiellin e kishte mbuluar një gri e rënduar prej lagështirës, gri mërzie. Por reshje s’pati. Duke përjashtuar çdo ngjyrë të ndezur, Sara vendosi për flokët: “Blu dhe balluke të shkurtër!” Për të tjerët bluja mund të ishte lutja e saj që moti të ndryshonte, ndërsa për partnerin e dikurshëm një kumt i qiellit veror. Sa do ta kapte nga skena këtë mesazh Edor Egro? Apo, pikërisht prej blusë, e dashura e dikurshme do t’i ngjante një moskokëçarëse e ftohtë?!

Sara Çesku kishte nisur të danconte me Edorin qysh në moshën, kur po i dilnin gjokset. Aq e pasionuar ishte si nxënëse, sa edhe në gjumë i buftonte zëri i tij: “E majta dy... e djathta katër... vetëm... kryqëzo.” Dhe kur zgjohej, sërish i përsëdyteshin këshillat e balerinit: “Çdo mëngjes, me anë të lëvizjeve, do të jesh në luftë me trupin tënd. Dhe kështu përditë, derisa të arrish nivelin që të mos jesh në luftë.” Pasi e kishte kapërcyer këtë nivel dhe koha u kishte dhënë gjinjve formën e plotë,